

**MONITORIMI I STRATEGJISË KOMBËTARE
PËR NDRYSHIMET KLIMATIKE, 2020 – 2030
PËR 2019 - 2021**

Të gjitha të drejtat në këtë dokument, përfshirë të drejtat e autorit, janë në pronësi të Fondacionit Westminster për Demokraci (WFD) dhe mbrohen nga ligjet e zbatueshme të Mbretërisë së Bashkuar dhe ato ndërkombëtare. Ky dokument nuk mund të kopjohet, ndahet, përkthehet në një gjuhë tjetër, apo të përshtatet pa leje paraprake nga WFD.

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.

Informacioni dhe pikëpamjet e shprehura në këtë raport janë ato të autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht opinionin zyrtar të WFD-së, financuesve të saj apo Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar. As WFD dhe as ndonjë person që vepron në emër të saj, nuk mund të mbahet përgjegjës për përdorimin që mund t'i jetë bërë informacionit që ai përmban.

NËNTOR 2021

Tabela e përmbajtjes

Tabela e përmbajtjes	3
Lista e Tabelave	5
Lista e grafikëve	5
Akronime.....	6
1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....	7
2. METODOLOGJIA E MONITORIMIT.....	8
2.1 Kufizime të metodologjisë	9
3. ADRESIMI I NDRYSHIMEVE TË KLIMËS	11
4. QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT E STRATEGJISË	12
5. PROFILI I RREZIKUT KLIMATIK PËR SHQIPËRINË.....	13
5.1 Gjendja social-mjedisore	13
5.2 Përmbledhje për klimën	13
5.3 Bujqësia.....	14
5.4 Burimet ujore	15
5.5 Shëndeti i njeriut	16
5.6 Zonat bregdetare	16
5.7 Energjia dhe infrastruktura	17
5.8 Ekosistemet.....	18
5.9 Katastrofat natyrore.....	18
5.10 Konteksti politik.....	19
5.11 Kuadri institucional	19
5.12 Strategjitë dhe planet kombëtare	20
6. KUADRI I BE-së PËR KLIMËN DHE ENERJINË	21
6.1 Raportet e BE-së mbi përparimin e Shqipërisë për ndryshimet klimatike	28
7. MONITORIMI I PERFORMANCËS NË TREGUESIT E MATRICËS.....	30
7.1 Shtylla Financiare	30
7.2 Ndihma e huaj për projektet e lidhura me klimën	42
7.4. Shtylla e kapaciteteve institucionale.....	50
7.5 Zhvillimi i Kapaciteteve në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, 2019-2021	57
7.6 Progresi i bërë lidhur me sistemin e monitorimit të klimës.....	58
8 GJETJE DHE REKOMANDIME	60
Gjetje	60

Rekomandime.....	62
Shtojca 1	65
Lista e projekteve të Ndhmës së Huaj për Shqipërinë, të lidhura me klimën (2019-2021).....	65
Shtojca 2:.....	67
Intervista gjysmë të strukturuar me Institucionet e Qeverisjes Qendrore.....	67
Bibliografia.....	68

Lista e Tabelave

Tabela 1	Përmbledhje për klimën në Shqipëri	13
Tabela 2	Stresorët klimatikë dhe rreziqet ndaj Prodhimit Bujqësor	14
Tabela 3	Stresorët klimatikë dhe rreziqet ndaj Burimeve Ujore	14
Tabela 4	Stresorët klimatikë dhe rreziqet ndaj Shëndetit të Njeriut	15
Tabela 5	Stresorët klimatikë dhe rreziqet ndaj Zonave Bregdetare	16
Tabela 6	Stresorët klimatikë dhe rreziqet ndaj Energjisë dhe Infrastrukturës	17
Tabela 7	Stresorët klimatikë dhe rreziku ndaj Ekosistemeve	17
Tabela 8	Kuadri i BE-së për Klimën dhe Energjinë	20
Tabela 9	Shpërndarja e fondeve sipas viteve	30
Tabela 10	Projekte të lidhura me klimën për 2019 nga Ministria e Energjisë dhe Infrastrukturës	31
Tabela 11	Projekte të lidhura me klimën për 2020 nga Ministria e Energjisë dhe Infrastrukturës	32
Tabela 12	Projekte të lidhura me klimën për 2021 nga Ministria e Energjisë dhe Infrastrukturës	33
Tabela 13	Projekte të lidhura me klimën për 2019 nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit	35
Tabela 14	Projekte të lidhura me Klimën për 2020 nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit	36
Tabela 15	Projekte të lidhura me klimën për 2021 nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit	37
Tabela 16	Projekte të lidhura me klimën për 2021 nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	38
Tabela 17	Financimi i projekteve lidhur me ndryshimet klimatike 2019-2021	39
Tabela 18	Financimi i projekteve lidhur me ndryshimet klimatike sipas sektorëve	39
Tabela 19	Ndihma e huaj për projektet e lidhura me klimën 2019-2021	44
Tabela 20	Ligjet dhe vendimet e lidhura me ndryshimet klimatike për 2020-2021	44
Tabela 21	Masat prioritare Nr.6 e Strategjisë kombëtare për ndryshimet klimatike	50
Tabela 22	Veprimtaritë e zhvillimit të kapaciteteve raportuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, 2019-2021	51
Tabela 23	Programet e MIE për 2019-2021	55

Lista e grafikëve

Grafiku 1	Burimet e Financimit në Shqipëri sipas sektorëve	29
Grafiku 2	Burimet tërësore të financimit në Shqipëri, sipas donatorëve	30
Grafiku 3	Shpërndarja e shpenzimeve për klimën sipas sektorëve	40
Grafiku 4	Boshllëku financiar i shpenzimeve për klimën	41
Grafiku 5	Ligjet dhe vendimet e lidhura me klimën, krahas legjislacionit për gjithë sektorët në tërësi, miratuar në 2019	46
Grafiku 6	Ligjet dhe vendimet e lidhura me klimën, krahas legjislacionit për gjithë sektorët në tërësi, miratuar në 2020	46
Grafiku 7	Ligjet dhe vendimet e lidhura me klimën, krahas legjislacionit për gjithë sektorët në tërësi, miratuar në 2021	47
Grafiku 8	Numri i ligjeve dhe vendimeve të lidhura me klimën, krahas zhvillimeve ligjore në tërësi sipas viteve	48
Grafiku 9	Ligjet dhe vendimet për klimën, ndaj ligjeve për mjedisin sipas viteve	49
Grafiku 10	Veprimtaritë për klimën organizuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, sipas viteve	54

Akronime

AEE	Agjencia për Eficencën e Energjisë
AKBN	Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore
AKM	Agjencia Kombëtare e Mjedisit
AKP	Agjencia Kombëtare e Pyjeve
AKZM	Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura
AMBU	Agjencia e Mbrojtjes së Burimeve Ujore
BE	Bashkimi Evropian
CEMSA	Konsolidimi i Sistemit të Monitorimit të Mjedisit në Shqipëri
COVID 19	Korona Virus 2019
GEF	Fondi Global për Mjedisin
GES	Shkarkimet me Efekt Serrë
GGE	Shkarkimet e Gazeve me Efekt Serrë
GIZ	Agjencia Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar
IPA	Instrumenti i Para-anëtarësimit në BE
IPCC	Paneli Ndërkombëtar për Ndryshimet Klimatike
KE	Komisioni Evropian
KfW	Banka Gjermane për Zhvillim
KKKBN	Komunikimi i Katërt Kombëtar
KKKBNK	Konventa Kuadër e Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike
KKP	Kontributi Kombëtar i Pikësnyuar
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
MIE	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
MTM	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
NPTP	Ndryshimi i Përdorimit të Tokës dhe Pyjeve
OECD	Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik
OSHC	Organizata të Shoqërisë Civile
PBA	Plan Buxhetor Afatmesëm
PBB	Prodhim i Brendshëm Bruto
QBM	Qendra Burimore e Mjedisit, Shqipëri
RIS	Shërbimi i informacionit për lumenjtë (River Information Services)
RRSHTN	Regjistri i Shkarkimit dhe Transferimit të Ndotjes
RRTE	Transporti Hekurudhor Trans-Evropian (Railroad Transport in Europe)
SANE	Mbështetje Shqipërisë në Negociatat për Mjedisin
SELEA	Mbështetje për Formimin e Zbatimit të Legjislacionit Mjedisor në Shqipëri
SESAR	Një qiell i vetëm Evropian
SIDA	Agjencia Suedeze për Bashkëpunim Ndërkombëtar
SKNK	Strategjia Kombëtare për Ndryshimet Klimatike
SNAP	Planet Kombëtare të Masave Përshtatëse
SSN	Rrjet Detesh të Sigurta
SWAN	Platforma e Ripërdorimit të Mbetjeve të Ngurta në Ballkan
TEN-T	Rrjeti Trans-Evropian i Transportit
TVSH	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar
UNDP	Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara
UNEP	Programi i Kombeve të Bashkuara për Mjedisin
UNIDO	Organizata për Zhvillimin Industrial e Kombeve të Bashkuara
WFD	Fondacioni Westminster për Demokracinë

1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Strategjia Kombëtare për Ndryshimet Klimatike dhe Plani i Veprimit (SKNK) është dokumenti kryesor strategjik që adreson ndryshimet klimatike në Shqipëri. Strategjia është miratuar nga Qeveria e Shqipërisë në vitin 2019 dhe është hartuar në mbështetje të legjislacionit të BE për mjedisin dhe klimën dhe synon fuqizimin e koordinimit mes sektorëve lidhur me masat e përshtatjes, mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e qëndrueshëm. Fokusi i SKNK është zbutja dhe përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike në Shqipëri. Shqipëria mori statusin e vendit kandidat të Bashkimit Evropian në Qershor 2014. Procesi i pranimit të Shqipërisë në BE është një forcë shtytëse për reformimin e sektorit të mjedisit dhe koordinimin ndër sektorial të nevojshëm ndaj përshtatjes me ndryshimet klimatike. Integrimi nënkupton bashkëpunim të ngushtë me rregulloret e BE -së.

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit përmes Njesisë për Ndryshimet Klimatike është pika qendrore kombëtare e KKKBNK. Njësia bashkëpunon me një ekip teknik ndërdisiplinor dhe ndërinstucional për të përmbushur detyrat e Shqipërisë si palë e KKKBNK. Inspektorati Shtetëror i Mjedisit identifikon dhe u përgjigjet çështjeve që lidhen me mjedisin dhe ndryshimet klimatike. SKNK është hartuar për të mbështetur zbatimin e legjislacionit të BE-së për mjedisin dhe klimën, që synon forcimin e koordinimit midis sektorëve lidhur me masat e përshtatjes ndaj klimës, mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e qëndrueshëm. Fokusi i SKNK është vënë në zbutjen dhe përshtatjen e ndryshimit të klimës në Shqipëri.

Ky raport i parë monitorues mbi zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Ndryshimet Klimatike 2020-2030, bazohet në monitorimin e treguesve të lidhur me disponueshmërinë e 'inputeve' për ndryshimet klimatike, duke qenë se Shqipëria është një vend me një ekonomi në zhvillim që karakterizohet nga një tranzicion i gjatë. Për rrjedhojë i ka të rëndësishme financat, legjislacionin dhe zhvillimin institucional, të cilët konsiderohen faktorë mundësues në reagimin e vendit ndaj ndryshimeve klimatike. Është gjithashtu me rëndësi të mbahet në konsideratë se miratimi i Strategjisë Kombëtare për Ndryshimin e Klimës nga qeveria e Shqipërisë është relativisht i zhvillimit të vonë (korrik 2019), nga ku progresi gjatë periudhës 2019-2021 është ndikuar nga dy faktorë me një ndikim të rëndësishëm:

- ✓ Tërmeti që goditi vendin në nëntor 2019
- ✓ Mbyllja e vendit për shkak të pandemisë që shkaktoi COVID-19

Objektivat kryesorë të këtij raporti monitorues janë:

- ✓ T'u sigurojë vendimmarrësve një kuadër informacioni që përmirëson procesin e vendimmarrjes drejt ndryshimit të klimës;
- ✓ Të rrisë njohuritë midis aktorëve të shoqërisë civile mbi përparimin e zbatimit të strategjisë;
- ✓ Të nxisë pjesëmarrjen dhe veprimin e OShC-ve në proceset e vendimmarrjes për klimën.

Nuk është e qartë se çfarë mekanizmi është përdorur në alokimin e buxheteve të strategjisë në sektorët e përfshirë, apo si janë bërë shpenzimet për këto fonde. Për shkak të mos disponueshmërisë së një informacioni të tillë, QBM analizoi PBA-të e Ministrisë së Turizmit dhe

Mjedisit, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për periudhën 2019-2021. Zbatimi i Strategjisë Kombëtare për Ndryshimin e Klimës shihet i lidhur me miratimin e një Politike për Zhvillimin e Kapaciteteve që rrjedh nga Strategjia Kombëtare për Ndryshimin e Klimës për të krijuar më shumë hapësirë veprimi për sektorët e përfshirë në qeverisje, institucione për të bashkëvepruar dhe koordinuar, dhe për vendin në Konventën Kuadër të OKB-së për Ndryshimet Klimatike (KKKBNK). Pengesa kryesore për mbështetjen e kufizuar të përshtatjes nga institucionet publike dhe paaftësia e tyre për të luajtur një rol më të mirë në ndërtimin e qëndrueshmërisë ndaj ndryshimeve klimatike, lidhen me boshllëqet në menaxhim, mungesën e burimeve financiare dhe fizike dhe mungesën ose trajnimin e pamjaftueshëm.

2. METODOLOGJIA E MONITORIMIT

Ky raport synon t'u vijë në ndihmë autoriteteve ligj-hartuese dhe vendimmarrëse në nivel qendror, njërive përgjegjëse për politikat ndër-sektoriale pranë institucioneve përgjegjëse, sektorëve që mbulojnë aspektet teknike dhe të monitorimit të klimës dhe aktorëve të shoqërisë civile.

Ky raport i parë monitorues i zbatimit të Strategjisë Kombëtare për Ndryshimet Klimatike, 2020-2030 është bazuar në monitorimin e treguesve që lidhen me *'input'*-et e vëna në dispozicion të klimës, kryesisht sepse Shqipëria është një vend me ekonomi në zhvillim, që karakterizohet nga një tranzicion ekonomik në evoluim, pra që i ka të rëndësishme financat dhe kuadrin ligjor që mundëson reagimin për klimën.

Gjithashtu, miratimi i Strategjisë Kombëtare për Ndryshimet Klimatike nga Qeveria e Shqipërisë është një zhvillim relativisht i vonë (korrik 2019), nga ku ecuria e procesit përgjatë dy-vjeçarit të fundit është përcaktuar nga dy faktorë shumë të rëndësishëm me ndikim të ndjeshëm në adresimin në nivel vendi të tranzicionit për klimën, si në vijim:

- ✓ Tërmeti që goditi vendin në muajin Nëntor 2019
- ✓ Mbyllja dhe ngadalësimi i vendit për shkak të pandemisë COVID-19

Kohështrirja e vlerësimit monitorues: Raporti merr përsipër të analizojë angazhimin e qeverisë me *'input'*-e për periudhën e kohës nga miratimi i strategjisë e deri në shtator 2021.

Treguesit e përdorur të inpute-ve përfshijnë:

- ✓ Financimet e qeverisë, agjencive të huaja dhe mbështetjes dypalëshe për klimën.
- ✓ Kapacitetet teknike dhe institucionale, kuadrin ligjor për të shqyrtuar ecurinë e aspekteve të përmbushjes apo mangësive në procesin e zbatimit të strategjisë.

Për realizimin e raportit janë shfrytëzuar dhe analizuar të dhëna nga burimet online të informacionit; është bërë grumbullim i dedikuar Informacioni në nivel të institucioneve qendrore (PBA-të e ministrive përgjegjëse, raporte të trajnimit dhe kualifikimit) janë realizuar intervista me përfaqësuesit e pikave fokale për klimën pranë ministrive dhe me departamentet e burimeve njerëzore.

Matrica e monitorimit përbëhet nga tre shtylla të rëndësishme, me aspekte të ndryshme të ndërlidhura që janë përshtatur për analizën, si në vijim:

Shtylla financiare:

1. Analizë të trendit të disbursimit të financave publike, siç parashikohet në angazhimin financiar 3-vjeçar të qeverisë dhe planin e veprimit të tranzicionit për klimën, 2019-2022.
2. Vlerësimi i fondeve për klimën mobilizuar nga qeveria e Shqipërisë, nëpërmjet mbështetjes së ofruar nga donatorë të ndryshëm për projektet të lidhura me klimën; ose fondet IPA II.

Shtyllat ligjore dhe politike:

3. Aktet e reja ligjore që lidhen me klimën të miratuara gjatë 2019-2021.

Shtylla institucionale dhe e kapaciteteve:

4. Vlerësimi i rritjes apo forcimit të kapaciteteve institucionale në agjencitë publike që luajnë rol të rëndësishëm në veprimin ndaj klimës.
5. Vlerësimi i punës së qeverisë në ngritjen e sistemit të monitorimit të klimës për zbatimin e strategjisë klimatike.

2.1 Kufizime të metodologjisë

Gjatë punës për monitorimin e strategjisë, grupi i punës ndeshi një seri kufizimesh me ndikim në procesin e monitorimit dhe të informacionit që përmbante produkti i kësaj detyre. Kufizimet i kemi parashtruar në paragrafët më poshtë:

- ✓ Nuk ka një instrument të monitorimit të strategjisë, të tillë që të mund të vlerësojë progresin e masave të marra, apo të analizojë input-et dedikuara për klimën. Ndarja e përgjegjësive mes disa agjencive të pushtetit qendror, pa pasur një institucion udhëheqës që përgjigjet për mbikëqyrjen, koordinimin ndër-institucional, grumbullimin e të dhënave dhe monitorimin krijon copëzim të serisë së të dhënave monitoruese ndaj objektivave në tërësi të Strategjisë.
- ✓ Angazhimi financiar i qeverisë i shprehur përmes planeve tre-vjeçare nuk është i gjurmueshëm për shkak se buxheti i linjave që përfshin SKNK nuk shoqërohet me kode që shërbejnë për të kanalizuar alokimin e tyre sipas sektorëve/programeve.
- ✓ Në programet/projektet që janë pjesë e PBA-ve të buxhetit të shtetit, mungojnë treguesit në pikë përqindjeje të pjesës që zënë financimet e drejtpërdrejta për klimën. Për rrjedhojë, përpunimi i të dhënave financiare në kontekstin e klimës është me shumë përafërsi.
- ✓ Mungesa e objektivave ndërsektoriale dhe të një baze të dhënash për zhvillimin institucional në kuadër të shportës së programeve dhe projekteve që janë në zbatim. Disponimi i këtij informacioni është i rëndësishëm për të siguruar që njohuritë të përmirësohen dhe ofrohen në varësi të nevojave që paraqesin sektorë të ndryshëm.
- ✓ Baza e të dhënave me informacione mbi projektet e ndihmës së huaj për klimën në Shqipëri ofron informacion të pamjaftueshëm që nuk lidhet me treguesit e monitorimit të Strategjisë.

Për të shmangur perceptimin e gabuar që mund të ndërtohet në shifra të pasakta, raporti përfshin vetëm projektet e miratuara nga qeveria e Shqipërisë. Për më tepër, duket se ka një vakum informacioni në lidhje me projektet më të vogla për klimën në Shqipëri.

3. ADRESIMI I NDRYSHIMEVE TË KLIMËS

Shumë vende janë gjithnjë e më tepër nën ndikimin e ngjarjeve ekstreme të motit, si: përmbytjet, periudhat me thatësi, stuhitë dhe parametra të tjerë. Shkalla e ndjeshmërisë ndaj klimës përcaktohet pjesërisht nga ekstremet më të fundit të ndryshueshmërisë së klimës, si edhe nga ndjeshmëria e vendeve ndaj ngjarjeve përkeqësuese që ndikohen nga: përvojat e mëparshme, kushtet socio-ekonomike apo problemet e trashëguara nga e kaluara. Shkalla me të cilën ndjeshmëria ndaj motit ndikon në ekonominë e një vendi përcaktohet nga kapacitetet përshtatëse të tij.

Shqipëria është një nga vendet më të prekshme në rajon prej ndryshimeve klimatike. Tendencat e ndryshimeve klimatike janë vënë re kryesisht gjatë 15 viteve të fundit me: rritjen e temperaturave, uljen e reshjeve dhe një shfaqje më të shpeshtë të fenomeneve ekstreme të motit, si periudhat me thatësi dhe përmbytjet. Parashikimet e klimës, paralajmërojnë ulje të sasisë së reshjeve në stinën e verës me 10 % deri në 2020, dhe 20 % deri në vitin 2050. Dy sektorët më të ndikuar nga ndryshimet klimatike janë Energjia dhe Bujqësia. Sidoqoftë, raportet e KE për vitet 2020-2021 paraqesin një tendencë përmirësuese të vlerësimit për vendin që citon: *“Shqipëria ka arritur një lloj progresi për sa i përket adresimit të ndryshimeve klimatike, por harmonizimi i legjislationit të vendit me kuadrin evropian është ende i kufizuar”*¹.

Megjithatë, Raporti i Progresit për 2020, njeh në mënyrë të shprehur miratimin e Strategjisë Kombëtare për Ndryshimet Klimatike për 2019-2030, me objektiva për 2050. Të gjithë raportet përmendin sfidat e mëdha përpara Shqipërisë, gjatë procesit të negociatave me BE-në dhe anëtarësimit, për shkak të objektivave të rinj të klimës vendosur nga BE. Mungesa e strukturave të caktuara dhe personelit të nevojshëm për t'u marrë me ndryshimet klimatike është një çështje mjaft shqetësuese².

¹https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/albania-report-2021_en faqe 116

²https://www.google.com/url?sa=t&rct=j&q=&esrc=s&source=web&cd=&ved=2ahUKEwixwKn7q9zzAhWLCOWKHa0ZCmgQFnoECAYQAQ&url=https%3A%2F%2Fec.europa.eu%2Fneighbourhood-enlargement%2Fsystem%2Ffiles%2F2020-10%2Falbania_report_2020.pdf&usq=AOvVaw29NBvoceEd8O9244xPX9dC faqe 107

4. QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT E STRATEGJISË

Strategjia Kombëtare për Ndryshimet Klimatike dhe Plani i Masave janë hartuar për t'i ardhur në ndihmë zbatimit të legjislacionit të BE-së për klimën dhe mjedisin, i cili synon forcimin e bashkërendimit mes sektorëve, lidhur me masat zbutëse për klimën, mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e qëndrueshëm.

Strategjia adreson një tërësi masash zbutëse dhe përshtatëse ndaj ndryshimeve klimatike në Shqipëri. Dokumenti përfaqëson një plan të përgjithshëm ndër-sektorial që siguron një përmbledhje të objektivave, politikave dhe masave të synuara zbutëse dhe përshtatëse ndaj klimës, sipas sektorëve përkatës duke propozuar një plan zhvillimi të vendit me shkarkime të ulëta karboni.

Strategjia Kombëtare për Ndryshimet Klimatike, përmes masave zbutëse ka si objektiva afatgjatë reduktimin e shkarkimeve dhe rritjen e kapjes së këtyre shkarkimeve në sektorët e përfshirë, në përputhje me objektivin e BE-së, për të reduktuar me 80% deri në 95% deri në vitin 2050 shkarkimet e CO₂, krahasuar me nivelet e shkarkimeve të vitit 1990.

Dokumentit strategjik mbulon katër sektorë raportues të inventarit të gazeve serë: Energjia me fokus të veçantë Transportin; Ndryshimi i Përdorimit të Tokës dhe Pyjeve, Mbetjet; Ndërtesat dhe Industria, të cilat janë përgjegjëse për 80% të shkarkimeve të CO₂ në Shqipëri.

5. PROFILI I RREZIKUT KLIMATIK PËR SHQIPËRINË

Ky profil përmban një paraqitje të rrezikut klimatik për Shqipërinë, përfshirë ndikimin e mundshëm në të ardhmen për sektorët si bujqësia, burimet ujore, shëndeti publik, zonat bregdetare, ekosistemet, energjia dhe infrastruktura. Përmbledhja përfshin një pamje të klimës dhe projeksionin e ndryshimit të saj.

5.1 Gjendja social-mjedisore

Shqipëria është një vend i vogël me një ekonomi të brishtë që mbështetet në sektorin e shërbimeve, industrisë dhe bujqësisë, i cili po përballlet me shumë sfida në adresimin e rreziqeve që vijnë prej ndryshimeve klimatike.

Vendi karakterizohet nga një rritje ekonomike e pabarabartë. Ka një peizazh kryesisht malor, të pajisur me burime të bollshme ujore, shumëllojshmëri të llojeve bimore dhe shtazore, si dhe me një vijë bregdetare me dalje të gjerë në detet Adriatik dhe Jon duke krijuar një terren të favorshëm për përmytje sezonale.

Ndër sfidat e tjera përfshihen erozioni i tokës i krijuar nga njeriu dhe natyra, zhvillimi i parregulluar i bregdetit, pasiguria mbi pronën dhe ndotja e rezervave të ujit të pijshëm, të cilat shoqërohen nga një shkallë e ulët e ndërgjegjësimit të publikut për ndryshimet klimatike. Vartësia ndaj ndryshimeve të klimës, e sektorëve që kanë të bëjnë me furnizimin e vendit me energji dhe bujqësi, e kombinuar me një seri përmytjesh të mëdha të kohëve të fundit, rrëshqitjet e tokës, etj., kanë rritur nevojën e përballimit të pasojave të klimës me masa gatishmërie, që është vlerësuar si një nga prioritetet e planit të zhvillimit të vendit.

5.2 Përmbledhje për klimën

Shqipëria bën pjesë në brezin sub-tropikal ndaj dhe klima e Shqipërisë ndjek topografinë e vendit, me ndryshime në temperaturën dhe reshjet sipas lartësisë dhe largësisë nga deti. Pjesa më e madhe e reshjeve bie në periudhën nëntor - mars, ndërsa gjatë muajve qershor- shtator reshjet janë më të pakta si pasojë e rritjes së temperaturave.

Tabela 1: Përmbledhje e klimës në Shqipëri

Historiku i Klimës	Klima në të ardhmen
<p>Tendenca historike e klimës i ka fillesat që në vitet 1960, nga ku përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> ✔ Rritjen e temperaturave mesatare vjetore me 1 ° C. ✔ Një rritje prej gjashtë deri në tetë herë të intensitetit. kohëzgjatjes dhe numrit të valëve të të nxehtit përgjatë gjithë Mesdheut Lindor. ✔ Zvogëlim të lehtë të reshjeve mesatare vjetore, por statistikisht të parëndësishëm. ✔ Ngritjen e nivelit të detit Adriatik, e cila lidhet me rritjen e stuhive dhe dëmtimet nga bora; një erë e ftohtë, e thatë verilindore; dhe Shiroku, erë me drejtim jug-juglindje. 	<p>Dinamika e ndryshimit të reshjeve në Shqipëri është e pasigurt, por sipas studimeve shkencore më të fundit, vërehet një tendencë për ngrohjen e motit në të ardhmen: me dimër më të butë, verë dhe vjeshtë më të nxehtë dhe më të thatë.</p> <p>Parashikimi i klimës deri në vitin 2050 përfshin:</p> <ul style="list-style-type: none"> ✔ Rritjen intensive të temperaturës (2.4 °C në 3.1 °C) nga muaji qershor - gusht. ✔ Zvogëlimin e sasisë së reshjeve vjetore (më pak se 10 %), me zvogëlim më të madh të sasisë në periudhën qershor - Shtator. ✔ Rritje e sasisë së reshjeve të shiut, për shkak të zëvendësimit të reshjeve të borës me reshje shiu, duke zvogëluar potencialisht akumulimin sezonal të borës. ✔ Rritje të episodeve të stuhive me shi të dendur. ✔ Përmbytje përgjatë vijës bregdetare. <p>Parashikimet klimatike në Shqipëri përfshijnë: rritje të temperaturës; mot më ekstrem me përmbytje, thatësira, valë të nxehti; dhe ndryshueshmëri të reshjeve shoqëruar me rënie të sasive mesatare në periudhën e verës.</p>

5.3 Bujqësia

Bujqësia, një nga sektorët më të ndjeshëm ndaj klimës, kontribuon me 22.6% në Prodhimin e Brendshëm Bruto (PBB)³ dhe është burimi kryesor i punësimit për popullsinë rurale të vendit. Puna në fermë siguron kryesisht një standard të ulët jetese, prandaj aktiviteti kryesor në këtë sektor është në mbarështimin e blegtorisë, që zë më shumë se 50% të vlerës së prodhimit, kulturat fushore si: gruri dhe misri, që zënë rreth 30% dhe prodhimin e frutave⁴ për pjesën e mbetur.

Topografia e kufizon mundësinë për një shkallë të lartë mekanizimi. Bonifikimi i tokës dhe shndërrimi i kullotave kanë përshpejtuar procesin e shpyllëzimit dhe erozionit, duke ndikuar në rritjen e rrezikut për përmbytjet dhe rrëshqitjet e tokës.

Plani Kombëtar i vitit 2016, synonte të përmirësonte procesin e ujitjes dhe kullimin, për të zvogëluar dëmet që vijnë si pasojë e përmbytjeve periodike dhe rrëshqitjeve të tokës. Plani i qeverisë për vitin 2021, synon të përmirësojë punën për sa i përket investimeve që lidhen me vaditjen dhe drenazhimin⁵.

⁴Grupi i Bankës Botërore (2021): Shqipëria – Profili i vendit për rreziqet e klimës, faqe 16

⁵Raporti i përditësuar i KKP (2021) në proces miratimit

Tashmë, ndryshimet klimatike po ndodhin me ritme të shpejta në Evropë, duke përforcuar nevojën për zgjidhje të menjëhershme, afatmesme dhe afatgjata, të cilat mund të ndihmojnë sektorin e bujqësisë duke zvogëluar ndikimet negative të ndryshimeve klimatike.

Ndryshimet në modelin e rënies së reshjeve; rritja e temperaturave dhe shpeshtimi; si dhe ashpërsimi i fatkeqësive natyrore, po i detyron njerëzit t'i trajtojnë këto ndikime me mënyra të reja e novatore dhe të fillojnë të përshtaten me klimën që ndryshon.

Ndikimi i ndryshimeve klimatike dhe efektet e saj në bujqësi, kanë ndikim mbi popullsinë në nivel global, në përgjithësi ku popullsia që banon në zonat rurale do të jetë më e prekur.

Zvogëlimi i reshjeve dhe rritja e fatkeqësive natyrore që pritet të ndodhin gjatë pesë dekadave të ardhshme në vendin tonë, kërkon që të punohet me fermerët për t'i ndihmuar në zbutjen dhe parandalimin e pasojave tepër serioze që vijnë si pasojë e ndryshimeve klimatike.

Tabela 2: Stresorët klimatikë dhe rreziqet ndaj prodhimit bujqësor

Faktorët klimatikë dhe rreziqet klimatike	
PRODHIMI BUJQËSOR	
Pasojat	Kërcënimet
Rritja e temperaturave në stinën e dimrit dhe të verës Ulja e sasisë së ujit gjatë muajve kritikë të verës	Zhvillim i përshpejtuar i të korrave, shkurtim i ciklit të rritjes
	Rritja e rendimentit për disa kultura (gruri); si dhe zvogëlimi i rendimentit për disa kultura të tjera, si misri ose zvogëlimi i foragjereve për bagëtinë, etj
	Rritja e përmbajtjes së kripës dhe shkretëtirëzimi i tokës
	Rritja e ngordhjeve në bagëti dhe ulja e produktivitetit të tyre
	Rritja e ekspozimit ndaj dëmtueseve dhe sëmundjeve të reja

5.4 Burimet ujore

Shqipëria ka burime të bollshme të ujërave të ëmbla, por ndryshimet klimatike pritet të shkaktojnë ndryshime sezonale në sasinë e ujit të disponueshëm dhe në përdorimin e tij. Lumenjtë e mëdhenj janë shumë erozivë dhe përmytjet sezonale janë të zakonshme, ndaj rreziku më i lartë paraqitet kryesisht në ultësirën perëndimore të vendit. Menaxhimi i dobët dhe mungesa e investimeve për ujitjen dhe infrastrukturën e kullimit të lidhura me mbrojtjen ndaj përmytjeve, kanë përkeqësuar dëmet dhe humbjet e shkaktuara nga reshjet e dendura të vitit 2014, 2015, 2016 dhe 2018⁶.

Tabela 3: Stresorët klimatikë dhe rreziqet ndaj burimeve ujore.

Faktorët klimatikë dhe rreziqet klimatike	
BURIMET UJORE	
Pasojat	Kërcënimet
Zvogëlimi i sasisë së reshjeve dhe ulja e sasisë së borës së rënë	Ndryshimet ose pakësimi i prurjes së lumenjve, veçanërisht në stinën e verës.
	Ujërat nëntokësore pakësohen nga zvogëlimi i sasisë së ujërave sipërfaqësorë dhe humbja e lagështirës së tokës.

⁶ Grupi i Bankës Botërore (2021): Shqipëria – Profili i vendit për rreziqet e klimës, faqe 18

Thatësira dhe përmytje më të shpeshta	Devijime të modeleve të rënies së reshjeve: rënie e mundshme e sasisë në stinën e pranverës dhe rritje gjatë stinës së dimrit.
	Dëmtimi i infrastrukturës së furnizimit me ujë, trajtimit të ujërave të zeza, të ujitjes dhe kullimit nga përmytjet.

5.5 Shëndeti i njeriut

Programi Kombëtar i Veprimit për Përshtatjen dhe Shëndetin (H-NAPA) identifikoi ngjarjet ekstreme të motit, cilësinë e ajrit dhe sëmundjet ngjitëse, si rreziqet kryesore të lidhura me shëndetin, në një klimë që ndryshon.

Sipas parashikimeve të përgjithshme për Ballkanin në tërësi, vdekjet me ndikim më të madh në shëndet, janë ato që lidhen me të nxehtin, veçanërisht në grupin e të moshuarve; informacioni mbi efektet e tjera me ndikim të drejtpërdrejtë ose jo-të drejtpërdrejtë të klimës në shëndetin e njeriut është i kufizuar.

Tabela 4: Stresorët klimatikë dhe rreziqet ndaj shëndetit.

Faktorët klimatikë dhe rreziqet klimatike	
SHËNDETI I NJERIUT	
Pasojat	Kërcënimet
Rritja e temperaturave	Rritja e vdekshmërisë nga i nxehti dhe përkeqësimi i kushteve ekzistuese
Valët e të nxehtit bëhen më të shpeshta, më të gjata dhe intensive.	Temperatura e larta ndikojnë në përqendrimin ose shpërndarjen e ndotësve të ajrit
	Rritja e gamës së sëmundjeve të transmetuara nga vektorët (p.sh., mushkonjat)

5.6 Zonat bregdetare

Ndikimet e ndryshimeve klimatike mund të prekin pothuajse pjesën më të madhe të popullsisë, rreth 97% e popullsisë që jetojnë brenda 100 kilometrave të zonës bregdetare⁷.

Kjo do të thotë që afekton dhe popullatën në periferi të kryeqytetit. Duke marrë parasysh dhe popullatën në Durrës dhe në zonat e tjera perëndimore, kjo gjë afekton gjysmën ose më shumë, të popullatës së vendit.

Zhvillimi jo i rregullt i ndërtimeve urbane deri në bregdet ekspozon infrastrukturën dhe popullsinë, si pasojë e dëmtimit nga stuhitë, përmytjet dhe ngritja e nivelit të detit që mund të ndodhë në të ardhmen.

Shpyllëzimi i zonave bregdetare, zhvillimi bujqësor dhe përdorimi i zhavorrit dhe rërës për ndërtim janë disa nga faktorët që kanë ndikuar në erozionin bregdetar, duke rritur kështu shkallën e ndjeshmërisë ndaj ndryshimeve klimatike.

Ndikimet e ndryshimeve klimatike për peshkimin artizanal nuk janë studiuar në detaje, por ky sektor mund të ndikohet nga rritjet e pritshme të temperaturës në sipërfaqen e detit.

⁷Grupi i Bankës Botërore (2021): Shqipëria – Profili I vendit për rreziqet e klimës, faqe 26

Tabela 5: Stresorët klimatikë dhe rreziku ndaj zonave bregdetare.

Faktorët klimatikë dhe rreziqet klimatike ZONAT BREGDETARE	
Pasojat	Kërcënimet
Rritja e nivelit të detit	Dëmtimi i infrastrukturës bregdetare përfshin objektet e turizmit dhe tokën bujqësore
Rritja e intensitetit të stuhive	Ndryshime në ekosistemet lagunore, ligatinave dhe brezit pyjor bregdetar
Rritja e temperaturave në sipërfaqen e detit	Rritja e kripësisë së akuaferëve bregdetarë të ujërave të ëmbla
	Rritja të përmytjeve në bregdet deri në vitin 2100

5.7 Energjia dhe infrastruktura

Shqipëria mbështetet në basenin e lumit Drin për më shumë se 90% të furnizimit të hidrocentraleve me fuqi hidrike. Ky pellg lumor mund të ketë prurje të reduktuara për shkak të ndryshimit të klimës, të cilat do të ndikojnë në furnizimin me energji.

Shqipëria është tashmë e prekshme nga luhajtjet e reshjeve, dëshmuar nga thatësira e vitit 2007, e cila solli mungesa të mëdha të energjisë. Së bashku me dëmtimet në infrastrukturën bregdetare, rrëshqitjet e tokës dhe përmytjet në ultësirën perëndimore dhe zonat bregdetare kanë shkaktuar dëme të mëdha në infrastrukturë. Trafiku i rënduar urban në Shqipëri, koha e gjatë e përdorimit të automjeteve dhe pluhuri i rrugëve me zhavorr krijojnë ndotje të ajrit, e cila mund të përkeqësohet me rritjen e temperaturave dhe mungesës së reshjeve për periudha të gjata.

Ndryshimet e klimës parashikohet të kenë ndikim të rëndësishëm në sektorin e energjisë në Shqipëri. Për të adresuar këto sfida të afërta, politikë-bërësit në vend në bashkëpunim me programet e ndihmës si Banka Botërore, ndërmorën një vlerësim pilot mbi cënueshmërinë, rrezikun dhe përshtatjen në sektorin e energjisë në Shqipëri, për të rritur ndërgjegjësimin dhe për të filluar dialogun mbi përshtatjen e sektorit të energjisë.

Ky vlerësim pilot demonstroi një qasje që mund të përdoret për të ndihmuar vendet dhe palët e interesuara të zhvillojnë politika dhe projekte që fuqizojnë përballjen me pasiguritë klimatike dhe ndihmojnë në menaxhimin e problemeve energjetike që krijohen si pasojë e ndryshimeve klimatike.

Tabela 6: Stresorët klimatikë dhe rreziku në sektorët e energjisë dhe infrastrukturës

Faktorët klimatikë dhe rreziqet klimatike ENERGJIA DHE INFRASTRUKTURA	
Pasojat	Kërcënimet
Rritja e temperaturave	Zvogëlim i potencialit të hidrocentraleve Ndryshim të kërkesës sezonale për ngrohje dhe ftohje
Thatësira më të shpeshta	Konkurrencë për burimet ujore midis sektorëve të hidroenergjisë dhe bujqësisë (ujitjes)
Rritje e ngjarjeve ekstreme të motit	Zvogëlim i efikasitetit të linjave të transmetimit dhe shpërndarjes për shkak të rritjes së temperaturës Dëme në infrastrukturë shkaktuar nga përmbytjet

5.8 Ekosistemet

Afërsisht 18 % e territorit të Shqipërisë është zonë e mbrojtur tokësore ose detare. Gati 19 % e llojeve të florës dhe faunës janë të rrezikuara; pjesërisht për shkak të ndotjes, mbi-peshkimit dhe tjetërsimit të funksionit të tokës. Problematikë ë veçantë nga ndryshimet klimatike vërehet në zonat ligatinore, të cilat gjenden nën stresin e eutrofikimit dhe të shfaqjes së llojeve aliene.

Stresi dhe tharja e vegjetacionit, për shkak të temperaturave të larta është shoqëruar me një numër rekord të zjarreve në pyje në verën e vitit 2007, por edhe në vitet e fundit dhe sidomos në vitin 2021.

Ndërtimet e paligjshme ose të parregulluara, veçanërisht në zonat bregdetare, kanë rritur ndjeshmërinë e banorëve dhe të ekosistemeve ndaj stuhive.

Tabela 7: Stresorët klimatikë dhe rreziku ndaj ekosistemeve.

Faktorët klimatikë dhe rreziqet klimatike EKOSISTEMET	
Pasojat	Kërcënimet
Rritje e temperaturave	Rrezik i shtuar i zjarreve në pyje
Rritje e shpeshtësisë për ngjarjet ekstreme të motit	Zhvendosja e habitatit, humbja dhe copëzimi i habitateve, duke cenuar mbijetesën e llojeve dhe prishur modelet e migrimit të llojeve Zvogëlimi i sasisë së ujit të ëmbël, duke kërcënuar zonat ligatinore

5.9 Katastrofat natyrore

Shqipëria po përballet me valët e të nxehtit, thatësirën, rrëshqitjet e tokës dhe përmbytjet, të cilat mund të përkeqësohen për shkak të ndryshimeve klimatike. Erozioni i tokës, shpyllëzimi dhe ndërtimet e parregullta kanë ndikimin në ngjarjet ekstreme të motit, sikundër migrimi rural-urban, që çon në rritjen e vendbanimeve jo-formale dhe rritjen e nivelit të ndjeshmërisë ndaj këtyre ndryshimeve.

Grumbullimi i të dhënave dhe ndarja e punës mes institucioneve për të monitoruar e vlerësuar rreziqet, si dhe për të përmirësuar sistemet e paralajmërimit të hershëm mbetet një sfidë.

Shqipëria ka marrë financime nga donatorët që synojnë forcimin e sistemeve të menaxhimit të rrezikut nga fatkeqësitë.

5.10 Konteksti politik

Shqipëria ka fituar statusin e vendit kandidat të Bashkimit Evropian në qershor të vitit 2014. Procesi i pranimit të Shqipërisë në BE është një forcë shtytëse në reformimin e sektorit të mjedisit dhe të koordinimit ndër-sektorial, aq të nevojshëm për reagimin përshtatës ndaj ndryshimeve klimatike. Integrimi nënkupton bashkëpunim të ngushtë dhe të drejtpërdrejtë me kuadrin ligjor dhe rregullator të BE-së.

5.11 Kuadri institucional

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit përmes Njesisë për Ndryshimet Klimatike, është pika qendrore në nivel kombëtar për zbatimin e Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike (KKKBNK). Njësia bashkëpunon me një ekip teknik ndërdisiplinor dhe ndërinstucional për të përmbushur detyrat e Shqipërisë si anëtare e KKKBNK⁸.

Inspektorati Shtetëror i Mjedisit identifikon dhe u përgjigjet çështjeve që lidhen me mjedisin dhe ndryshimet klimatike. Përgjegjësitë e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit përfshijnë lejimin, vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe informacionin publik.

Draft-Strategjia Kombëtare e Shqipërisë, mbi zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile, ende në proces miratimi, thekson nevojën për të përmirësuar dhe zgjeruar rrjetin ekzistues vëzhgues të stacioneve të motit dhe hidrometeorologjike. Raporti i KE, 2021 cilëson *“Nevojitet një rishikim i shpejtë i strategjisë, tashmë të vjetër dhe i planit kombëtar të veprimit, në kontekstin e planeve vendore dhe nivel prefektore, të emergjencës. Kapacitetet administrative, infrastruktura dhe sistemi i paralajmërimit të hershëm nuk janë ende në lartësinë e duhur”*⁹.

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) është përgjegjëse për sektorin e energjisë dhe është ngarkuar të përgatisë, rishikojë dhe përditësojë në mënyrë periodike Strategjinë Kombëtare të Energjisë; zhvillimin e politikave energjetike dhe strategjive afatmesme dhe afatgjata për sektorin e energjisë; të zhvillojë reformat e tregut në sektor për të përmbushur objektivat kombëtare dhe në përputhje me direktivat e Bashkimit Evropian (BE); të formulojë kornizën e duhur ligjore; dhe të promovojë eficientë e energjisë, burimet e energjisë së rinovueshme dhe investimet në sektor përmes krijimit të një mjedisi të favorshëm për investime¹⁰. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë është përgjegjëse për politikën kombëtare të klimës dhe bashkëpunimin ndërkombëtar për ndryshimet klimatike në këndvështrimin e eficientë së energjisë dhe energjitë e rinovueshme në Shqipëri¹¹. Sektori përgjegjës është Drejtoria e Programeve të Zhvillimit për Energjinë dhe Efiçencën e Energjisë.

⁸Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (www.turizmi.gov.al)

⁹https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/albania-report-2021_en faqe 115

¹⁰Agjencia Ndërkombëtare e Energjisë së Rinovueshme (IRENA), 2021: Shqipëria – Energjitë e rinovueshme, Gatishmëria dhe Vlerësimi faqe 25

¹¹Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë www.infrastruktura.gov.al

5.12 Strategjitë dhe planet kombëtare

Kuadri kombëtar për klimën ka qenë dinamik por dokumentet e para janë hartuar në fillim të viteve 2000. Ndonëse kanë kaluar 20 vite, zhvillimet më thelbësore kanë ndodhur në vitet e fundit, me strategjinë kombëtare dhe ligjin për klimën. Në mënyrë kronologjike, dokumentat kryesorë për klimën paraqiten në vijim:

- ✓ [Komunikimi i Parë Kombëtar \(2002\)](#) dhe [Komunikimi i Dytë Kombëtar \(2009\)](#). Komunikimi i dytë fokusohet në zonën e Kaskadës së Lumit Drin. [Komunikimi i Tretë Kombëtar \(2016\)](#). [Komunikimi i Katërt](#) në përpunim
- ✓ [Strategjia Shqiptare e Ministrisë së Shëndetësisë për Përshtatjen e Sistemit Shëndetësor në Ndryshimet Klimatike \(2011\)](#) paraqet një plan veprimi për vitet 2011–2021
- ✓ [Përshtatja ndaj Ndryshimeve Klimatike në Deltën e Lumit Drini dhe Përtej \(2013\)](#) propozon strategji të politikave për të marrë parasysh konsideratat e përshtatjes së ndryshimeve klimatike në Planin Kombëtar, Rajonal dhe Vendor të Zhvillimit
- ✓ [Strategjia Kombëtare për Ndryshimet Klimatike dhe Planin e Veprimit, 2020-2030](#)

6. KUADRI I BE-së PËR KLIMËN DHE ENERGJINË

Shqipëria si një vend që është pjesë e kontinentit Evropian dhe e proceseve anëtarësuese në BE e ka orientuar vullnetin politik dhe përpjekjen e saj për klimën në frymën e angazhimeve drejt kuadrit Evropian, që përfaqëson standardin më të lartë ligjor dhe rregullator në nivel global për mjedisin dhe klimën.

Tabela 8: Kuadri i BE-së për klimën dhe energjinë¹²

	Pikat kyçe/objektivat	Përmbledhje
DIREKTIVA (BE) 2018/2002 E PARLAMENTIT DHE KËSHILLIT EVROPIAN I 11 Dhjetorit 2018 për ndryshimin e Direktivës 2012/27 / BE për efikasitetin e energjisë	<ul style="list-style-type: none"> ✔ Objektivi prej 30% i efikasitetit të energjisë planifikuar deri në 2030; ✔ Zvogëlimi i konsumit parësor të energjisë me 32.5% deri në vitin 2030 në nivelin e BE-së. 	<p>Reduktimi i konsumit dhe humbjes së energjisë ka një rëndësi në rritje për BE-në. Në vitin 2007, pjesëtarët e KE-së vendosën një objektiv për të ulur konsumin vjetor të energjisë të BE-së me 20% deri në vitin 2020. Në 2018, u vendos një objektiv i ri, për të ulur konsumin e energjisë me të paktën 32.5% deri në 2030, si pjesë e paketës "Energjia e Pastër për të gjithë Evropianët". Masat për efikasitetin e energjisë njihen gjithnjë e më shumë si një mjet jo vetëm për të arritur një furnizim të qëndrueshëm të energjisë, për të ulur shkarkimet e gazrave serë, për të përmirësuar sigurinë e furnizimit, për të zvogëluar faturat e importit, por edhe për të promovuar fuqinë konkurruese të BE-së. Pra, efikasiteti i energjisë ka përparësi strategjike për Komunitetin e Energjisë. Kuadri i politikës së ardhshme për periudhën pas 2030 është në diskutim.</p>
LIBRI I GJELBËR Një kornizë e vitit 2030 për politikën e klimës dhe energjisë	<ul style="list-style-type: none"> ✔ Ulje e shkarkimeve të gazeve serë me të paktën 40% (nga nivelet e vitit 1990); ✔ Pjesa e totalit të energjisë së rinovueshme të arrijë të paktën 32%; ✔ Përmirësim i efikasitetit të energjisë me të paktën 32.5%. 	<p>Kuadri i klimës dhe energjisë për 2030 përfshin qëllime dhe objektiva të politikës në gjithë BE-në për periudhën nga 2021 deri në 2030. 40% e Objektivit për shkarkimet e gazrave serë, bazohet në Sistemin e Tregimit të Shkarkimeve të BE-së, Rregullorja për Përpjekjet e Përbashkëta ndaj objektivave për uljen e shkarkimeve nga Shtetet Anëtare dhe Rregullorja për Përdorimin e Tokës, Ndryshimi i Përdorimit të Tokës dhe Pyjeve. Në këtë mënyrë, gjithë sektorët mund të kontribuojnë në arritjen e objektivit për zvogëlimin me 40% të shkarkimeve dhe eliminimin e shkarkimeve. Tre pjesët përbërëse të legjislacionit për klimën do të përditësohen me qëllim që të zbatohet propozimi për reduktimin me të paktën 55% të shkarkimeve të gazrave serë. Komisioni do të paraqesë propozimet deri në Korrik 2021.</p>

¹²https://ec.europa.eu/environment/nature/natura2000/platform/news/eu_guide_environmental_directives.htm

<p>LIBRI I BARDHË Udhërrëfyesi i një zone të vetme evropiane të transportit - Drejt një sistemi transporti konkurrues dhe të burimeve efikase</p>	<ul style="list-style-type: none"> ✓ Përgjysmim i përdorimit të makinave me karburante fosile në transportin urban deri në vitin 2030; ndalimi i përdorimit të tyre në qytete deri në vitin 2050; krijimi i logjistikës në qytete për zero shkarkime të CO2 në qendrat kryesore urbane deri në vitin 2030. ✓ Shkarkimet e lëndëve djegëse me karbon të ulët për aviacionin të arrijnë 40% deri në 2050; gjithashtu deri në vitin 2050 të ulen shkarkimet e CO2 të BE-së nga karburantet e anijeve me 40% (nëse është e mundur 50%). ✓ Deri në 2030, 30% e transportit rrugor për distanca mbi 300 km duhet të zëvendësohet me mënyra të tjera transporti, të tilla si transporti hekurudhor ose ujor, dhe më shumë se 50% deri në vitin 2050, duke u lehtësuar nga korridoret e efektshme dhe të gjelbër të transportit. Për të përmbushur këtë qëllim do të kërkohet gjithashtu që të zhvillohet infrastruktura e duhur. ✓ Deri në vitin 2050, të përfundohet një rrjet hekurudhor evropian i shpejtësisë së lartë. Deri në 2030, të trefishohet gjatësia e rrjetit ekzistues hekurudhor me shpejtësi të lartë dhe të mbahet një rrjet hekurudhor i dendur në të gjitha Shtetet Anëtare. ✓ Deri në vitin 2050, pjesa më e madhe e transportit të udhëtarëve në distancë të mesme duhet të jetë hekurudhor. ✓ Deri në 2030, zhvillimi i një Rrjeti 'thelbësor' modular për Transportin Trans-Evropian (RRTTE) plotësisht funksional në të gjithë BE-në, për t'u shndërruar në një rrjet me cilësi dhe kapacitet të lartë deri në vitin 2050 dhe një grup përkatës të shërbimeve të informacionit. ✓ Deri në vitin 2050, të lidhet i gjithë rrjeti i aeroporteve bazë, 	<p>Një transformim i sistemit Evropian të transportit do të jetë i mundur vetëm përmes një kombinimi të nismave të shumëfishta në të gjitha nivelet. Veprimet dhe masat e ndryshme të treguara në këtë Udhërrëfyese do të shtjellohen më tej. Komisioni do të përgatisë propozimet e duhura legjislative në dekadën e ardhshme, me nismat kryesore që do të paraqiten gjatë mandatit të tanishëm. Secili prej propozimeve do të paraprihet nga një vlerësim i plotë i ndikimit, duke marrë parasysh vlerën e shtuar për BE-në dhe aspektet e vartësisë. Komisioni do të sigurojë që veprimet e tij të rrisin aftësinë konkurruese të transportit duke siguruar një ulje minimale prej 60% të shkarkimit të gazeve serë nga transporti, deri në vitin 2050, në linjën e dhjetë synimeve që duhet të shihen si pika referimi.</p>
--	--	---

	<p>me rrjetin hekurudhor, mundësisht me shpejtësi të lartë; të sigurohet që të gjitha portet kryesore detare të jenë të lidhura mjaftueshëm me sistemin e transportit hekurudhor dhe, kur është e mundur, me sistemin e rrugëve ujore në brendësi të vendit.</p> <ul style="list-style-type: none"> ✓ Vendosja e infrastrukturës së modernizuar të menaxhimit të trafikut ajror (kërkimi ATM për një Qiell të Vetëm Evropian, në Evropë deri në vitin 2020 dhe kompletimi i Zonës së Përbashkët Evropiane të Aviacionit. Vendosja e sistemeve ekuivalente të menaxhimit të transportit ujor dhe tokësor (Sistemi i Menaxhimit Evropian i Trafikut Hekurudhor, Sistemet e Transportit Inteligjent, Rrjeti i Sigurt Detar, Gjurmimi dhe Identifikimi me Rreze të Gjatë, Shërbimet e Informacionit për Lumenjtë). Vendosja e Sistemit Satelitor Evropian të Lundrimit Global (Galileo). ✓ Deri në vitin 2020, të krijohet kuadri për një sistem evropian modular informacioni, menaxhimi dhe pagese për transportin. ✓ Deri në vitin 2050, viktimat e aksidenteve rrugore të ulen në thuajse zero. Në përputhje me këtë qëllim, BE synon që deri në 2050 të përgjysmojë viktimat nga aksidentet rrugore. BE duhet të kryesojë në nivel global treguesit e mbrojtjes dhe sigurisë, në të gjitha format e transportit. ✓ Kalimi drejt aplikimit të plotë të parimeve; "përdoruesi paguan" dhe "ndotësi paguan" dhe angazhim të sektorit privat, për të eliminuar devijimet, përfshirë subvencionimin e projekteve me ndikim negativ, gjenerim të ardhurash dhe financim të investimeve në sektorin e transportit. 	
<p>PARAQITJE NGA LETONIA DHE KOMISIONI EVROPIAN NË EMËR TË BASHKIMIT EVROPIAN DHE</p>	<ul style="list-style-type: none"> ✓ Deri në 2030, reduktimi me të paktën 40% i shkarkimeve të gazeve serë. ✓ Reduktimi i shkarkimeve në të gjithë sektorët ekonomikë, 	<p>BE dhe Shtetet Anëtare janë të angazhuara për të përbushur së bashku objektivin e reduktimit me së paku 40%, të shkarkimeve në nivel vendi, deri në 2030, krahasuar me vitin 1990, siç parashikohej në konkluzionet e Këshillit Evropian, Tetor 2014.</p>

<p>SHTETET ANËTARE TË TIJ. Kontributi i Përcaktuar në shkallë Kombëtare i BE-së dhe Shteteve Anëtare të saj</p>	<p>përkundër shkarkimeve të vitit bazë.</p> <ul style="list-style-type: none"> ✓ Përfshirja edhe e gazeve serë, që nuk kontrollohen nga Protokollin e Montrealit (CO₂, CH₄, N₂O, HFCs, PFCs, SF₆, NF₃). ✓ Mbulimi i shkarkimeve duhet të jetë i plotë, 100%. 	
<p>DIREKTIVA (BE) 2018/410 E PARLAMENTIT EVROPIAN DHE E KËSHILLIT të 14 Marsit 2018 që ndryshon Direktivën 2003/87/KE për të rritur zvogëlimin e shkarkimeve me kosto efektive dhe investimet me karbon të ulët, dhe Vendimi (BE) 2015/1814</p>	<p>1. Faza 1 (2005-2007) Faza I është një eksperiment 3-vjeçar, i të mësuarit nga përvoja, si parapërgatitje për fazën e dytë, dhe Sistemi i Tregtimit të Shkarkimeve duhet të funksionojë në mënyrë efektive për të ndihmuar BE-në të përmbushë objektivat e Kiotos. Veçoritë kryesore të fazës 1:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. U mbuluan vetëm shkarkimet e CO₂ nga gjeneratorët e energjisë dhe industrinë me energji intensive; 2. Pothuajse të gjitha lejet iu dhanë bizneseve pa pagesë; 3. Gjoha për mos-zbatimin e këtyre rregullave ishte 40 € për ton. <p>Sipas Raporteve vjetore të Tregut të Karbonit të Bankës Botërore, gjatë kësaj fazë, volumet e tregtisë u rritën nga 321 milion leje në 2005, në 1.1 miliard në 2006 dhe 2.1 miliard në 2007.</p> <p>2. Faza 2 (2008-2012) Faza e dytë përkoi me periudhën e parë të angazhimit për Protokollin e Kiotos, ku shtetet e BE-së, si pjesë të Sistemit të Tregtimit të Shkarkimeve (STSH), duhej të përmbushnin objektiva konkrete në reduktimin e shkarkimeve. Disa nga karakteristikat kryesore të fazës së dytë:</p> <ul style="list-style-type: none"> ✓ Kufi më i ulët për lejet (me rreth 6.5% krahasuar me 2005). ✓ Rënie e lehtë, deri 90% e pjesës që mbulon shpërndarjeve pa pagesë. ✓ Gjoha për mos pajtueshmërinë u rrit me 100€ për ton. ✓ Bizneset u lejuan të blejnë kredite ndërkombëtare kundrejt një totali ekuivalent me rreth 1.4 miliard tonë CO₂. <p>Në vitin 2010, lejet e BE-së përbënin 84% të vlerës së tregut të përgjithshëm global të karbonit. Vëllimet e tregtimit u rritën nga 3.1 miliard në 2008 në 6.3 miliard në 2009. Në 2012, u tregtuan 7.9 miliardë leje (me vlerë 56 miliardë €).</p> <p>3. Faza 3 (2013-2020) Në fazën 3 të STSH të BE-së (2013-2020), kufiri në të gjithë Bashkimin Evropian për instalimet e palëvizshme u shoqërua me një faktor linear zvogëlimi prej 1.74% në vit. Kufiri i vitit 2013 ishte vendosur në bazë të</p>	<p>Sistemi i Tregtimit të Shkarkimeve të BE-së:</p> <ul style="list-style-type: none"> ✓ operon në të gjitha vendet e BE-së përfshirë Islandën, Lihtenshtajnin dhe Norvegjinë (shtetet e Zonës Ekonomike Evropiane-Shoqata Evropiane e Tregtisë së Lirë); ✓ kufizon shkarkimet në rreth 10,000 instalime, në sektorin e energjisë dhe industrisë prodhuese, si dhe të linjave ajrore që operojnë midis këtyre vendeve; ✓ mbulon rreth 40% të shkarkimeve të gazrave serë, për BE-në.

	sasisë totale të lejeve të lëshuara mesatarisht, për vit – në periudhën 2008-2012. 4. Faza 4 (2021-2030) Në fazën 4 të STSH të BE-së (2021-2030), kufiri i shkarkimeve synohet të ulët me 2.2 % në vit.	
Institucionet publike me interes të veçantë për vlerësimin monitorues të kapaciteteve janë konsideruar ministritë e linjës së sektorëve që preken nga ndryshimet klimatike (si Mjedisi; Transporti dhe Energjia; Bujqësia). Zhvillimi i kapaciteteve është një aktivitet i vazhdueshëm që ndodh brenda një mjedisi të caktuar institucional, ndaj dhe sfida e mbledhjes së të dhënave nga ministritë arriti një tjetër nivel gjatë kohës së përgatitjes së këtij raporti, pasi periudha e monitorimit përkoi me tranzicionin e administratës në nivel qendror nën kabinetin e ri që pritej të konfirmohej në Shtator (pas zgjedhjeve elektorale të muajit Qershor).

Hartimi i Raportit varej thuajse tërësisht nga informacioni që pritej të na vihej në dispozicion nga burimet ministrore brenda ministrive përkatëse. Për njërin nga ministritë kemi mungesë të dhënash, ndërsa për dy ministritë e tjera informacioni është në rastin më të mirë, një grumbullim kronologjik i seminareve dhe takimeve. Ndërsa hartimi i Strategjisë Kombëtare për Ndryshimet Klimatike dhe qëllimet - e materializuara në marrëveshjet ndërkombëtare - janë një arritje e rëndësishme, praktikisht strategjia ka shënuar vetëm fillimin e proceseve të brendshme të nevojshme për zbatimin e masave të kërkuara në arritjen e qëllimeve të përcaktuara. Ndonëse me zhvillimin e këtij dokumenti, është bërë një punë e konsiderueshme për sa i përket hartimit të politikave për klimën në nivel vendi, në fakt dokumenti nuk përfshin ndonjë vlerësim se cila qasje, ose kombinim qasjesh janë më të përshtatshmet për rrethanat kombëtare. Hartimi i masave të strategjisë është më tepër një përzierje e planeve të ekstrapoluara nga strategjitë e sektorëve të tjerë, ndoshta duke supozuar se shumica e madhe e planeve do të ishte e zbatueshme. Ky moment vendimtar demonstroi mungesën e aftësive klimatike në pjesën e boshtit të kapaciteteve institucionale të sektorit publik.

Institucionet qendrore përgjegjëse për çështjet e klimës janë Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë. Të dyja këto institucione janë përgjegjëse për hartimin e kuadrit ligjor dhe rregullator dhe zhvillimin e dokumenteve strategjike për klimën. MTM është e orientuar më shumë në aspektet e politikave të klimës në përgjithësi, me fokus të veçantë në masat adaptuese për klimën, ndërkohë që MIE është përgjegjëse për hartimin e kuadrit ligjor dhe rregullator në lidhje me energjinë (energjitë e rinovueshme dhe eficientë të energjisë duke u fokusuar më shumë në masat përshtatëse ndaj klimës. Nga shqyrtimi i strukturës së këtyre dy institucioneve vërejmë se MTM nuk ka të përfshirë në strukturë, sektor përgjegjës për klimën. Pranë kësaj ministrie ekziston një njësi përgjegjëse për klimën nën sektorin e politikave mjedisore. Në MIE struktura përgjegjëse për klimën është e shprehur si sektor i veçantë për energjitë e rinovueshme dhe eficientë të energjisë, kuadri i punës i së cilës është i fokusuar tek projektet dhe investimet në këtë fushë. Në përgjithësi numri i personave të punësuar në këto njësi është i vogël. Në disa raste 2-3 persona, që vlerësohet se është i pamjaftueshëm dhe nuk përmbush kapacitetet e nevojshme për të adresuar nevojat për klimën në secilin institucion.

Agjencitë në nivel qendror që kontribuojnë në çështjet e klimës janë Agjencia e Efiçencës së Energjisë (AEE) dhe në mënyrë të tërthortë AKM, AKBN, AMBU, AKP AMB, etj. AEE që është krijuar në 2016 dhe ka si objektiv “përmirësimin dhe promovimin e efikasitetit të energjisë gjatë gjithë ciklit të energjisë në të gjithë sektorët dhe zonat ekonomike të vendit, për të mundësuar konsumatorët të ulin kostot e furnizimit me energji dhe të zvogëlojnë ndikimet negative të ndotjes në mjedis dhe ndryshimet klimatike, asnjë nga agjencitë e tjera nuk ka një sektor të mirëfilltë përgjegjës për klimën”. AKM është përgjegjëse për grumbullimin e të dhënave lidhur me ndotjen, por pa arritur ende të diferencojnë ndotësit që lidhen vetëm me klimën. Ndërkohë agjencitë e tjera i trajtojnë çështjet e klimës kryesisht vetëm si adresim i pasojave që rrjedhin prej saj.

Në vijim është përfshirë informacioni i raportuar nga institucionet e analizuar përsa i përket zhvillimit të kapaciteteve institucionale.

Tabela 22: Veprimtaritë e zhvillimit të kapaciteteve raportuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, 2019-2021

(Mars 2019)

Krijimi i një Memorandumi i Mirëkuptimi midis PNUD, Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, Universitetit Politeknik të Tiranës dhe Universitetit të Gjirokastrës “Eqrem Çabej” për të mundësuar:

- ✓ Rritjen e kapaciteteve për menaxhimin e informacionit mjedisor, për nevojat e raportimit në Konventa Mjedisore Ndërkombëtare dhe thjeshtëzimin e tij për nivelin lokal;
- ✓ Njohjen me indikatorët mjedisorë në fushën e mbrojtjes së natyrës, që janë pjesë e raportimit kombëtar dhe në linjë me Agjencinë Evropiane të Mjedisit dhe Konventat e Rio-s për Biodiversitetin, Klimën dhe Shkretëtirëzimin, me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit;

- ✓ Trajnimin e palëve të interesuara, për aspekte të lidhura me: (i) indikatorët mjedisorë dhe raportimin në funksion të përmirësimit të politikave mjedisore, (ii) llogaritjen e shkarkimeve të gazeve serë në atmosferë dhe ndikimin që kanë në ngrohjen globale, sipas sektorëve ekonomikë.

(04 Mars 2019)

Nënshkrimi i Memorandumit të Mirëkuptimit u ndoq nga një seri aktivitetesh mjedisore dhe u përmyll edhe me mbjelljen e 120 fidanëve në qytetin e Gjirokastrës.

(29, Mars 2019)

Zhvillimi i veprimtarisë “Ora e Tokës” me nxënësit dhe stafin pedagogjik të Shkollës së Mesme të Përgjithshme “Sami Frashëri” në Tiranë. Pjesëmarrësit u njohën me çështjet e ndryshimeve klimatike dhe masat zbutëse. Në këtë aktivitet mori pjesë edhe Ministri i Turizmit dhe Mjedisit.

(19 Prill 2019)

Zhvillimi i Orës së Hapur me studentët e Kursit të Parë të Masterit Shkencor për Menaxhimin e Riskut, pranë Fakultetit Ekonomik. Drejtuesja e Programit të OKB për Shqipërinë për Ndryshimet Klimatike, parashtroi përpjekjet në nivel vendi, përkrah komunitetit global në adresimin e çështjeve të klimës.

(15-17 Maj 2019)

Në kuadër të zbatimit të Memorandumit të Mirëkuptimit midis Programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara, Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit të Shqipërisë, Universitetit Politeknik të Tiranës dhe Universitetit të Gjirokastrës “Eqrem Çabej”, në mjediset e Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit u zhvillua Seminari i Trajnimit për “Inventarizimin e Shkarkimeve të Gazeve me Efekt Serrë sipas metodologjisë së Panelit Ndërqeveritar për Ndryshimet Klimatike (IPCC) – 2006”. Seminari u lehtësua nga konsulentja ndërkombëtare, Znj. Maria Jose Lopez Blanco (Gauss SL). Pjesëmarrësit ishin 25, respektivisht nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, Agjencia e Eficiencës së Energjisë, Agjencia e Mjedisit, si dhe studentë të programeve Master Shkencor nga Universiteti Politeknik i Tiranës (departamenti i Inxhinierisë së Mjedisit, degët energji dhe trajtim ujërash) dhe Universiteti Bujqësor.

Trajnimi u shtri në 3 ditë:

Pjesa e parë iu kushtua çështjeve ndër-sektoriale dhe koncepteve të përgjithshme mbi:

- ✓ Inventarin e GES-ve;
- ✓ Inventari i GES për Shqipërinë - i përlogaritur në kuadër të Komunikimit të Tretë të Shqipërisë për Konventën Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike;
- ✓ Njohja me metodologjinë për inventarët e GES-ve – Elementet, Parimet, Ciklet;
- ✓ Njohja me Software-in e Inventarit IPCC;

- ✓ Zgjidhjet metodologjike dhe identifikimi i kategorive kryesore;
- ✓ Konsistenca e trendeve kohore;
- ✓ Mbledhja e të dhënave, AQ/QC, Verifikimi dhe vlerësimi i pasigurisë.

Pjesa e dytë iu kushtua 4 sektorëve të metodologjisë IPCC 2006: (i) Energjisë; (ii) Proceseve Industriale dhe Përdorimit të Produkteve; (iii) Bujqësisë, Pylltarisë dhe Përdorimit të Tokës; dhe (iv) Mbetjeve.

(07 Qershor 2019)

Përgjatë seancave paralele, u paraqit një përmbledhje e sektorëve, e cila u vijua nga prezantime mbi kategoritë e shkarkimeve, parimet dhe metodat e përlogaritjes së shkarkimeve. Prezantimet u shoqëruan me situata praktike, ku pjesëmarrësit u trajnuan edhe për 'software'-in e Inventarit të IPCC.

(23 Shtator 2019)

Zhvillimi i një aktiviteti promovues në qytetin e Vlorës, me rastin e Samitit të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike dhe Samitit të Vullnetit të Mirë, me temë: "Mbrojtja e Planetit dhe reagimi ndaj ndryshimeve klimatike". Ky aktivitet u ndoq nga një seri veprimtarish ndërgjegjësuese me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të pushtetit vendor, administratës së zonave të mbrojtura, institucioneve të edukimit dhe shoqatave mjedisore të qytetit.

(Shkurt 2020)

Seminar i përbashkët me përfaqësues të pikave fokale për çështjet gjinore dhe Konventën Kuadër për Ndryshimet Klimatike, pranë MTM, pjesëmarrjen e ekspertës rajonale për çështjet gjinore të lidhura me klimën, ekspertë kombëtarë, përfaqësues të PNUD, etj. ku u diskutua në lidhje me përpjekjet që po bëhen në kuadër të Komunikimit të Katërt Kombëtar për Ndryshimet Klimatike, për të adresuar lidhjen midis çështjeve gjinore dhe klimës. Në vijim të këtij takimi u mbështet pjesëmarrja e një ekipi nga Shqipëria në takimin e tretë rajonal për klimën dhe çështjet gjinore që u mbajt në Podgoricë në muajin Shkurt, 2020 – me mbështetjen e UNDP/UNEP për vendet jo-pjesë e Aneksit 1 të KKKBNK): Shqipëria prezantoi gjetjet dhe draft Planin Kombëtarë të Veprimit për Klimën dhe Çështjet Gjinore, me pjesëmarrje për herë të parë edhe të Znj. Etleva Bushati, Pikë Fokale Kombëtare për Ndryshimet Klimatike dhe Çështjet Gjinore në KKKBNK.

(15-17 Maj 2020)

Seminar trajnues për Inventarizimin e Shkarkimeve të Gazeve me Efekt Serrë, sipas metodologjisë së Panelit Ndërqeveritar për Ndryshimet Klimatike-2006 dhe rezultatet paraprake të inventarit për Shqipërinë (seritë kohore 2010-2016) për sektorët e (i) Energji, (ii) Procese Industriale dhe Përdorim Produkti dhe (iii) Mbetje. Për shkak të situatës COVID 19, seminari u zhvillua online me pjesëmarrjen e Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) në Tiranë, institucioneve shtetërore, Universiteti Politeknik të Tiranës, Degët Inxhinieri Mjedisori dhe Inxhinieri Mekanike. Pritet të zhvillohet edhe Seminari i Trajnimit në

sektorin e Bujqësisë dhe Pyjeve me pjesëmarrjen e stafeve/studentëve të Universitetit Bujqësor të Tiranës.

(21-23; 30 Shtator 2020)

Dy trajnime online të organizuara nga KKKBNK dhe Programi Global i Mbështetjes për Komunikimet Kombëtare të vendeve jo-pjesë e aneksit 1 të KKKBNK dhe UNDP/Zyra Rajonale për Vendet Arabe, lidhur me rishikimin e Kontributeve Kombëtare të Pikësnuara dhe adresimin përmes tyre të politikave për Reduktimin e Riskut nga Katastrofat Natyrore.

(26 Nëntor 2020)

Në kuadër të nismës së UNDP “Premtimi Klimatik” dhe në koordinim me Partneritetin për Kontributet Kombëtare të Pikësnuara të KKKBNK, me mbështetjen e ekspertizës ndërkombëtare, janë realizuar diskutimet parapake lidhur me metodologjinë dhe mënyrën e hartimit të raportit të rishikuar të KKP-së, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, Partneritetit për Kontributet Kombëtare të Përcaktuara, UNDP, institucioneve të linjës dhe ekspertëve të tjerë kombëtarë.

(28 Tetor, 20 Nëntor & 2 Dhjetor 2020)

Tre trajnime online, organizuar nga Programi Global i Mbështetjes për Komunikimet Kombëtare të vendeve jo-pjesë e Aneksit -1 të KKKBNK dhe Zyra Rajonale e UNDP në Stamboll, lidhur me Hartimin e Inventarëve të Gazeve serrë që gjeneron sektori i mbetjeve, Sistemet e Monitorimit, Raportimit dhe Verifikimit të inventarëve të shkarkimeve të gazeve dhe Politikat e Klimës.

(25 Janar 2020)

Trajnimi virtual me pjesëmarrjen e aktorëve të interesuar lidhur me Marrëveshjen e Parisit, Kontributet Kombëtare të Pikësnuara dhe procesin e përditësimit të tyre sipas kalendarit të miratuar, me rishikimin e dokumentit të Parë të Kontributit Kombëtar të Përditësuar për Shqipërinë.

(27 Janar 2021)

Takimi i parë virtual i Rrjetit Rajonal të Ekspertëve, organizuar nga Programi Global i Mbështetjes për Komunikimet Kombëtare të vendeve jo-pjesë e aneksit -1 në KKKBNK dhe Zyra Rajonale e UNDP-së në Stamboll.

(12 Mars 2021)

Shkëmbim përvojash dhe seminari trajnues me tematikë: Komunikimi i ndryshimeve klimatike, me pjesëmarrjen e zyrës rajonale të UNDP-së, zyrës së komunikimit pranë UNDP Tiranë, përfaqësuesve përgjegjës për komunikimin/informacionin në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, përfaqësues nga Ministria përgjegjëse në Maqedoninë e Veriut, si dhe nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit në Shqipëri.


(13-14 Prill 2021)

Rishikimi i Raportit të KKP-së, dhe shpërndarja e tij për komente, me aktorët e interesuar, agjencitë e zhvillimit dhe bankat zhvillimore, OJF-të universitetet. Komentet janë reflektuar gjerësisht dhe drafti final është ndarë me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, së bashku me dy dokumente shoqëruese. Drafti final është ndarë edhe me Programin Global të Mbështetjes për vendet e jo-pjesë e Aneksit -1 në KKKBNK, i cili përfaqëson edhe një ushtrim të fundit që vlerëson cilësinë e punës sipas standardit të metodologjisë.

(Veprimtari në proces)

Ka përfunduar draft-Plani për Zbatimin e dokumentit të rishikuar të KKP-së, i cili është ndarë me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit dhe aktorët e tjerë të interesuar. Diskutimet për produktin kanë përfshirë Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, ministritë e linjës, Agjencitë e zhvillimit dhe trupën diplomatike në Shqipëri, Zyrën e Kombeve të Bashkuara dhe UNDP, shoqërinë civile dhe përfaqësues të universitetit, institucione financiare ndërkombëtare, etj. Drafti pritet të plotësohet me vlerësimin e pasojave financiare (mundësuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Banka Botërore).

Grafiku 10: Veprimtaritë për klimën organizuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, sipas viteve



Nga veprimtaritë e raportuara nga MTM është bërë një filtrim i aktiviteteve që lidhen mirëfilli me zhvillimin e kapaciteteve brenda institucionit. Grafikët paraqesin një diferencim mes projekteve që janë realizuar kryesisht si bashkëpunim mes PNUD dhe MTM dhe aktiviteteve të trajnimit. Të dhënat e përfshira paraqesin vetëm tregues sasiore, jo të impaktit të këtyre veprimtarive në kapacitetet e institucionit.

Veprimtaritë e Raportuara nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për rritje kapacitetesh, 2019-2021

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit rural, raporton të dhënat e mëposhtme, në lidhje me veprimtaritë e zhvillimit të kapaciteteve:

Fushata ndërgjësuese për ndryshimet klimatike: 21 veprimtari (17 veprimtari me komunitetin e shkollave, 4 veprimtari me grupe fermerësh). Pjesëmarrës: 350 – 400 nxënës te shkollave 9 vjeçare, 80-100 fermerë;

- ✔ 2 Konsultime Kombëtare mbi ndikimin e ndryshimeve klimatike në bujqësi (60 pjesëmarrës nga pushteti qendror dhe vendor, fermerë/grupe fermerësh, OSHC, Institucionet akademike);
- ✔ 7 Trajnime mbi rolin e bujqësisë në mjedis dhe ndryshimet klimatike. 200 pjesëmarrës nga institucionet qendrore dhe lokale, fermerë, sektori privat, OSHC-të, etj.;
- ✔ 3 Trajnime mbi Zhvillimin e mençur të bujqësisë ndaj klimës dhe Menaxhimin Integruar të Dëmtueseve. Pjesëmarrës 48 (shërbimi i ekstensionit bujqësor, fermerë, sipërmarrës në bujqësi, agro-përpunues).

7.5 Zhvillimi i Kapaciteteve në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, 2019-2021

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë nuk ka raportuar asnjë aktivitet të zhvillimit institucional të lidhur me klimën. QBM Shqipëri ka shqyrtuar Raportet e Monitorimit të MIE për vitet 2019, 2020, të cilat përfshijnë njëmbëdhjetë programe.

Tabela 23: Programet e MIE për 2019-2021

1. Planifikim, Menaxhim dhe Administrim
2. Transporti Rrugor
3. Transporti Detar
4. Transporti Hekurudhor
5. Transporti Ajror
6. Furnizimi me ujë dhe kanalizime
7. Menaxhimi i mbetjeve urbane
8. Mbështetje për energji
9. Mbështetje për Burimet Natyrore
10. Mbështetje për Industrinë
11. Planifikim Urban

Raportet e Monitorimit përmendin në mënyrë të qartë ngritjen e kapaciteteve institucionale brenda Programit të Planifikimit, Menaxhimit dhe Administrimit. Fondet sipas këtij programi ishin parashikuar për funksionimin dhe forcimin e kapaciteteve administrative brenda Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë për të përmirësuar standardet dhe performancën institucionale në përmbushjen e objektivave. Edhe pse ky raport nuk përjashton mundësinë që zhvillimi institucional të ketë ndodhur, si një komponent brenda programeve të deklaruara në kornizën e mësipërme, formati në të cilin mbahet raportimi e bën të pamundur shkyçjen e aktiviteteve që lidhen me ngritjen e kapaciteteve. Kjo e bën akoma më të vështirë veçimin e veprimtarive të zhvillimit institucional të lidhura me klimën (nëse ka të tilla).

7.6 Progresi i bërë lidhur me sistemin e monitorimit të klimës

Progresi i bërë për sa i përket krijimit të inventarit të GES është në hapat e parë fare. Ligji për ndryshimet klimatike specifikon detyrimin e vendit për krijimin e një d/baze të GES, megjithëse aktet nën-ligjore të tij nuk janë miratuar ende. Për rrjedhojë shkarkimet GES vijojnë të llogariten në mënyrë të tërthortë. Ndërkohë ka një lloj progresi ligjor dhe institucional për sa i përket krijimit të 'data baza'-ve të tjera për ndotjen, të cilat mund të mbivendosen më raportimin GES.

Regjistri Shqiptar i Shkarkimeve dhe Transferimeve të Ndotjes është një bazë të dhënash elektronike publike që ndihmon pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrje që lidhen me fushën e mjedisit. Konkretisht, Regjistri Shqiptar i Shkarkimeve dhe Transferimeve të Ndotjes i mundëson publikut që të ketë qasje mbi informacionin mjedisor lidhur me shkarkimet ndotëse vjetore në ajër, ujë, tokë si dhe transferimet e ndotësve dhe trajtimin e ujërave ndotës urban.

Në sajë të Projektit CEMSA, që u financua me fondet IPA 2008, të BE u bë i mundur krijimi i regjistrave dhe procedurave për:

- ✓ Udhëzuesin manual të RRSHTN
- ✓ Strukturimin e RRSHTN
- ✓ Sistemet kompjuterike
- ✓ Listën paraprake të kompanive

Sërisht me mbështetjen e BE-së, përmes IPA 2010, u zbatua Projekti SELEA/ INPAEL (Janar 2012-Korrik 2014), i cili kishte si synim fuqizimin e kapaciteteve të Ministrisë së Mjedisit për hartimin dhe zbatimin e legjislacionit mjedisor.

Ndërsa pikat e forta për zbatimin e RRSHTN përfshijnë:

- ✓ Miratimin e Vendimit për zbatimin e RRSHTN-së, Shtator 2015.
- ✓ Kalimin e Sektorit të Lejeve në Agjencinë Kombëtare e Mjedisit. (që është lehtësi në krijimin e një liste operatorësh, subjekt i RRSHTN).
- ✓ Instalimi i server-ave/data bazave të ndryshme në Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, mes tyre dhe të software-it të RRSHTN, Maj 2014.
- ✓ Lejet Mjedisore sipas formatit të ri.
- ✓ Shkrijjen e Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve me Agjencinë Kombëtare të Mjedisit.
- ✓ Kalimin e Inspektoratit Mjedisor nën Drejtorinë Rajonale të Mjedisit, e cila varet nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit.

Pikat e dobëta të implementimit të RRSHTN janë:

- ✓ Vështirësi në identifikimin e të gjithë operatorëve industrialë që janë subjekte të RRSHTN-së.
- ✓ Mungesa e kapacitetit teknik të kompanive për të kryer monitorimin e shkarkimeve në mjedis dhe prodhimin e të dhënave të sakta.
- ✓ Cilësia e diskutueshme e të dhënave, mungesa e laboratorëve të certifikuar.

- ✓ Software i RRSHTN i aksesueshëm vetëm nga AKM, jo për publikun dhe operatorët industriale.
- ✓ Vështirësi në rritjen e ndërgjegjësimit të operatorëve industrialë për të raportuar në mënyrë vjetore sipas formatit të fundit.
- ✓ Mungesa e një udhëzuesi për të ndihmuar operatorët industrialë dhe AKM mbi zbatimin e RRSHTN-së.
- ✓ Mungesa e kapaciteteve për të krijuar një regjistër kombëtar me të dhënat e shkarkimeve nga aktivitetet industriale.
- ✓ Mungesa e kapacitetit teknik për të llogaritur shkarkimet rrjedhëse.

Aktualisht vijimësia dhe funksionimi i punës për RRSHTN në Shqipëri po mbështet nga Projekti “Avancimi i Regjistrave të Shkarkimit dhe Transferimit të Ndotësve (PRTRs) në vendet e Ballkanit Perëndimor dhe në Moldavi”, financuar nga Programi i Asistencës Këshilluese të Ministrisë Federale të Gjermanisë për Mjedisin, Konservimin Natyror dhe Sigurinë Nukleare, për mbrojtjen mjedisore në vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore, vendet e Kaukazit dhe Azisë Qendrore dhe vende të tjera fqinje me Bashkimin Evropian. Ky projekt mbikëqyret nga Agjencia Federale e Mjedisit në Gjermani (UBA) dhe zhvillohet nga QBM Shqipëri. Gjatë periudhës që përfshin monitorimi i zbatimit të strategjisë nuk është vërejtur përparim në zhvillimin e inventarit të GES. RRSHTN është regjistri i vetëm në të cilin AKM mbledh të dhëna nga një pjesë e operatorëve të biznesit. Bazuar në Ligjin e ri për Ndryshimet Klimatike, kërkohet raportimi i gazrave serrë, por për shkak të hyrjes në fuqi të ligjit për Ndryshimet Klimatike, në Korrik 2021 dhe mungesës së akteve të tjera rregulluese, mbledhja e të dhënave për GES-të nuk ka përparuar.

8 GJETJE DHE REKOMANDIME

Gjetje

Shtylla Financiare: Nuk ka një mekanizëm që të gjurmojë mënyrën si angazhohen fondet e specifikuar në strategji nëpër buxhetet e institucioneve, sipas sektorëve ose të mënyrës si bëhet regjistrimi/raportimi i këtyre shpenzimeve. Për shkak të mungesës së disponimit të një informacioni të tillë, QBM Shqipëri analizoi PBA-të e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për periudhën 2019-2021, duke zhvilluar një qasje alternative të vlerësimit empirik të financave, që janë angazhuar nga qeveria për programet e lidhura me klimën. Mungesa e kodeve buxhetore e bën të pamundur identifikimin e transaksioneve dhe gjenerimin e raporteve përkatëse që do të ndihmonin për të gjurmuar kostot.

Buxhetet e PBA-ve janë disa herë më pak se parashikimi i deklaruar në Strategjinë Kombëtare për Ndryshimet Klimatike (NK). GAP-i financiar vlerësohet të jetë rreth 49.7 miliardë lekë (7 herë më pak), megjithatë duke pasur parasysh që buxhetet nuk janë të lidhura me njëra-tjetrën, mundësia e matjes së GAP-it real financiar për klimën është e pamundur.

Konsideratë e rëndësishme: **Rezultatet e masave financiare** të përfshira në strategji **nuk mund të vlerësohen bazuar vetëm në sasinë e burimeve dhe jo në ndikimin e tyre.** Përgjithësisht, strategjitë për klimën përqipen të mbulojnë të dy kategoritë e veprimit: Dekarbonizimin (që referohet si "zbutje") dhe Përshtatjen. Dekarbonizimi, përqipet kryesisht të modifikojë shkallën e ndryshimit të klimës në periudhë të gjatë, për të shmangur pasojat katastrofike në nivel global. Ndërsa përshtatja fokusohet në përgjigjen shpesh në nivel komuniteti, ndaj pasojave të ndryshimeve klimatike – në situatën aktuale. Për shkak të burimeve të kufizuara, qeveria mund të ndihet nën presion për t'i dhënë përparësi njëres kategori ndaj tjetres. Sidoqoftë, të dyja janë të rëndësishme dhe reciprokisht përforcuese.

Nga shqyrtimi i PBA-ve, burimet financiare duket se janë shpërndarë në mënyrë asimetrike në projekte të efikasitetit të energjisë (përndryshe për 'zbutjen'), ndërsa 'përshtatja' është vetëm pjesë e planit.

Në periudhën 2019-2021, pjesa më e madhe e fluksit të parave të lidhura me klimën ka ardhur nga agjencitë e huaja dhe mbështetja teknike dypalëshe, por edhe për këtë lloj mbështetjeje të dhënat e marra janë të pjesshme dhe nuk specifikohen në %, apo çfarëdo treguesi tjetër që përcakton kontributin financiar për klimën.

Projektet e ndihmës së huaj, të lidhura me NK, janë 13 në total dhe kanë një kohëzgjatje të zbatimit të tyre që varion nga 1-5 vjet, kundrejt një totali prej rreth 258 milion euro. Megjithatë është e paqartë lloji i ndihmës nën të cilën përfshihet secili projekt (pra, nëse ndihma është një grant, ose një hua e butë), ose cili është kontributi i qeverisë në projekt, dhe ç'pjesë (në %) e ndihmës së huaj lidhet drejtpërdrejt me aktivitetet për klimën. Projektet e ndihmës së huaj ofrojnë përparësi unike në ndërtimin e vullnetit politik, duke inkurajuar koordinimin ndër-institucional dhe duke mobilizuar burime të ndryshme financimi për klimën. Megjithatë, të

menduarit për gjërat e mëdha, siç p.sh është integrimi i klimës në proceset zhvilluese nuk duhet t'i ngarkohet në kurriz funksionimit në përditshmëri të ndihmës së huaj.

Shtylla e Legjislacionit: Shqipëria ka ratifikuar amendamentin më të fundit të Protokollit të Montrealit, i njohur si Amendamenti Kigali, i protokollit të Kiotos dhe është një shtet palë në Konventën e Rios për Ndryshimet Klimatike.

Miratimi së fundi, i Ligjit për Ndryshimet Klimatike ka një rëndësi të veçantë pasi ka transferuar pjesërisht Direktivën 2003/87/EC për Sistemin e Tregtimit të Shkarkimeve (EU ETS) i ndryshuar, si dhe ka përshtatur Rregulloren (BE) Nr. 525/2013 për mekanizmin e monitorimit. Projektligji synon të sigurojë një kuadër ligjor dhe institucional gjithëpërfshirës në lidhje me veprimet që do të ndërmerren ndaj klimës në nivel kombëtar dhe në përputhje me kuadrin e BE-së për ndryshimet klimatike. Ky zhvillim pritet të lehtësojë kontributin e vendit në përpjekjet globale ndaj ndryshimeve të klimatike përmes përbushjes së detyrimeve të vendit si palë e Konventës, të përshpejtojë miratimin akteve kundër ndryshimeve klimatike duke zbutur efektet e dëmshme të ndryshimeve klimatike, si dhe të kontribuojë në zvogëlimin e shkarkimeve të gazeve serrë. Megjithatë, aktet nënligjore që pritet të miratohen ende mungojnë dhe zbatimi i legjislacionit mbetet prapa. Ndonjëherë legjislacioni është shumë i avancuar përballë kapaciteteve administrative, institucionale dhe financiare në vend.

Zhvillimi i Kapaciteteve Institucionale: Bazuar në pasqyrën e informacionit të marrë lidhur me veprimtaritë e zhvilluara në ngritje kapacitetesh në MTM, apo agjencitë e ndihmës së huaj në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, kategorizimin e tyre e kemi parë të lidhur me tre linja kryesore: (i) Veprimtari sensibilizuese/ndërgjegjësuese, (ii) Vijimësi pune me karakter teknik, (iii) Zhvillim Institucional.

Veprimtaritë me karakter të mirëfilltë të zhvillimit institucional janë disa, ku vlen të përmendim **trajnimet në lidhje me softin e IPCCve dhe inventarizimin e GES, zhvillimin e indikatorëve të klimës duke marrë në konsideratë perspektivën gjinore, reduktimin e riskut si aspekt të politikëbërjes, etj.** Veprimtaritë që lidhen me Komunikimin Kombëtar, KKP apo me detyrimet e vendit që burojnë nga marrëveshjet ku Shqipëria është pjesë shihen të lidhura në mënyrë më të drejtpërdrejtë me vijimësinë me karakter teknik të punës në MTM, ndërsa kanë padyshim rol edhe në zhvillimin personal dhe institucional të kapaciteteve, por jo me qëllim primar rritjen e kapaciteteve. Veprimtaritë e tjera siç janë takimet me studentët në auditorë, apo me nxënësit e shkollave shihen më të lidhura me edukimin apo ndërgjegjësimin e grupeve të caktuara shoqërore mbi të ardhmen e ndryshimeve klimatike.

Veprimtaritë e raportuara nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural i përbahen tematikave të gjera me një shpërndarje sasiore të tyre në tre tipologji kryesore veprimtarish ku përfshihen (i) ndërgjegjësimi, (ii) Trajnimet dhe (iii) Workshop. Ka informacion të munguar në lidhje me tematikën e ngushtë/specifike të trajtuar nëpër takime, vitin apo periudhën kur janë zhvilluar, etj, Për këtë arsye nuk ka qenë e mundur zhvillimi i një analize të thjeshte grafike lidhur me tendencën e tyre, sipas viteve. **Raporti i paraqitur ngjason më tepër me një assemblim numerik i veprimtarive tip, sesa një përshkrim tematik i angazhimit të MBZHR -së në zhvillimin e kapaciteteve.**

Pothuajse në të gjitha veprimtaritë përmbajtësore të zhvillimit institucional që lidhen me klimën (rasti i MTE), vërehet një përgjegjësi e përbashkët e realizimit të tyre me Programet e UN (kombëtare dhe rajonale), roli i të cilave duket të jetë thelbësor. **Kapacitetet e ministrisë vijojnë të vuajnë mungesën e maturimit për të lëvruar linja teknike pune.** Vlen të theksohet se dokumente të rëndësishme, të tilla si hartimi i Strategjisë Kombëtare për NK, plani i veprimit, përgatitja e Komunikimeve Kombëtare, përditësimi i KKP janë përgatitur të gjitha me mbështetjen e ndihmës së huaj.

Rastet kur zhvillimi institucional i lidhur me ndryshimet klimatike është realizuar me një qasje integruese ndaj sektorëve, janë mjaft të pakta. Shkak për këtë mund të jenë kufizimet që toleron puna në administratë, si p.sh mungesa e burimeve, tendenca e punës nëpër institucione që tenton drejt burokracisë hierarkike, puna në zyrë dhe mungesa e koordinimit.

Marrëveshja e Parisit, neni 11 thotë se ndërtimi i kapaciteteve duhet të jetë një proces efektiv, i vazhdueshëm, pjesëmarrës, ndër sektorial dhe i përgjegjshëm ndaj gjinisë. Në një farë mase, miratimi i një angazhimi të brendshëm - ka ndihmuar zhvillimin e kapaciteteve brenda institucioneve, por mbështetja dhe varësia nga ekspertët e huaj për çështjet e klimës janë të pashmangshme. Ky dimension institucional mund të ilustron me rastin e komunikimeve kombëtare mbi ndryshimet klimatike. Shqipëria përmes burimeve të veta ose asistencës së huaj, ka punësuar dhe/ose trajnuar ekspertë për të përgatitur një komunikim kombëtar. Sidoqoftë, një përfundim i suksesshëm i këtij projekti nuk garanton që vendi të ketë kapacitetin institucional për të përgatitur komunikime kombëtare - ose inventarë - në mënyrë të rregullt.

Aftësitë institucionale lidhur me klimën: Kapacitetet institucionale nuk janë faktori i vetëm përcaktues i politikave dhe veprimeve të lidhura me klimën në Shqipëri, në të ardhmen. Menaxhimi i ndikimeve të ndryshimit të klimës është veçanërisht i vështirë duke pasur parasysh shkallën dhe pasigurinë e përfshirë, natyrën komplekse dhe ndër sektoriale të ndryshimit të klimës dhe ngutin me të cilin kërkohen ndryshimet.

Urgjenca e nevojës për t'u marrë me ndryshimet klimatike shpesh ka çuar në mbështetjen e përpjekjeve afatshkurtra dhe 'ad hoc' që kanë adresuar rritjen e kapaciteteve, siç janë sesionet dhe seminarët një-ditore të trajnimit. Ndërsa, përshtatja ndaj klimës është fragmentuar vazhdimisht mes sektorëve dhe agjencive të ndryshme që veprojnë në zyra të mbyllura gjë e cila funksionon kundër objektivit të integritetit të përshtatjes dhe qasjeve ndërdisiplinore.

Rekomandime

Nisur nga të dhënat mbledhura nga KKP+5, Strategjia Kombëtare për Ndryshimet Klimatike dhe Plani i Veprimit duhet të rishikohet për të vendosur qasjet strategjike të ndërhyrjes sipas sektorëve më prioritarë, siç është për shembull transporti. Ky proces duhet të marrë parasysh përcaktimin e objektivave të vendit 2030/2050 për reduktimin e shkarkimeve. Plani i veprimit duhet të rishikohet dhe duhet të bazohet në një vlerësim të drejtë dhe realist, jo vetëm në lidhje me veprimet prioritare të nevojshme, por edhe burimet e vëna në dispozicion nga buxheti i shtetit ose ndihma e huaj që vepron në Shqipëri.

Financimi i aksionit për Ndryshimet Klimatike: Nevojitet një rishikim dhe rregullim i buxhetit për periudhat (2022-2024), (2025-2027), (2028-2030) të Strategjisë së NK-së **për të lejuar**

mundësinë e gjurmimit të shpenzimeve (përmes kodeve të buxhetit) dhe për të specifikuar në rrënjë mënyrën se si buxheti i dedikuar për klimën në Strategji, vjen i materializuar në PBA-të e sektorëve të prekur. Lidhja e linjave buxhetore me kodet buxhetore është e një rëndësie të veçantë, sepse u mundëson vetë institucioneve të bëjnë monitorimin dhe vlerësimin e tyre të performancës, por gjithashtu lejon organizatat ose agjencitë e përfshira në çështjet e klimës të punojnë me qeverinë në analizimin e efektivitetit financiar të programeve të qeverisë dhe donatorëve dhe të drejtojnë procesin në mënyrë të qartë dhe të pastër.

Programet / projektet që janë pjesë e **PBA-ve**, qoftë si financim i buxhetit të shtetit ose në bashkëfinancim me agjenci të huaja, duhet të bëjnë të dukshme (si pjesë në % të të gjithë buxhetit të programit) komponentët që lidhen drejtpërdrejt me zbutjen dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike. Disponimi i informacionit të zbërthyer në lidhje me financimin për klimën brenda programeve ose projekteve të PBA -së do të krijonte mundësinë për të ndarë informacionin financiar me palët e interesuara, OShC-të ose aktorët e tjerë, të cilat në rrethanat aktuale është e pamundur të ofrohen nga institucionet.

Në kuadër të punës së qeverisë, do të ishte e dobishme **të ngrihej një sistem të dhënash në nivel qendror** (p.sh. Zyra e Koordinimit të Donatorëve pranë Zyrës së Kryeministrit) për projektet e ndihmës së huaj të lidhura me klimën, që të përfshinte edhe projekte që nuk janë në bashkëfinancim me qeverinë, ose projekte tërësisht të mbështetur nga donatorët. Burime të tilla duhet të konsiderohen me vlerë të shtuar nga qeveria dhe mund të përdoren për të ndihmuar institucionet në rritjen e ndërgjegjësimit dhe zhvillimin e kapaciteteve.

Legjislacioni: Mungesa e akteve nënligjore mbi Ligjin për Ndryshimet Klimatike dhe Eficiencën e Energjisë pengon zbatimin në vend të ligjit. Duket se numri i akteve nënligjore që lidhen me Ligjin për Eficiencën e Energjisë ende për t'u miratuar është gjashtë (6). Sa i përket sistemit të monitorimit të shkarkimeve, është e nevojshme të integrohen të dhënat e kontribuesve lidhur me GGE-të në bazën e RRSHTN. Ende pritet miratimi i një numri të konsiderueshëm aktesh nën-ligjore të lidhura me Ligjin për Eficiencën e Energjisë. Përveç kësaj, nevojitet transpozim i shpejtë i legjislacionit tjetër të BE-së dhe miratimi i akteve rregullatore të cilat do të krijojnë bazën e nevojshme për raportimin e GGEs. Nisur nga mënyra si bëhet aktualisht raportimi nga operatorët industrial, përkundër regjistrave RRSHTN dhe Centraleve të Mëdha me Djegie të Brendshme, do të ishte e këshillueshme krijimi një mekanizmi të integruar raportimi, si një masë shtesë për të rritur efikasitetin e institucioneve por edhe të subjekteve industriale në përmbushjen e detyrimeve të tyre të raportimit.

Zhvillimi i Kapaciteteve Institucionale: Zbatimi i Strategjisë Kombëtare për Ndryshimet Klimatike duhet të shihet i lidhur me miratimin e një Politike të Zhvillimit të Kapaciteteve që rrjedh nga Strategjia për Ndryshimin e Klimës, për të krijuar më shumë fushë loje për sektorët e përfshirë në të gjithë qeverisjen ose institucionet që të bashkëveprojnë dhe koordinohen, por edhe për vendin në kuadër të KKKBNK. Kapacitetet nevojiten në të gjitha fazat e procesit të politikë bërjes. Zhvillimi i politikave ecën paralel me një sistem të fortë të monitorimit, raportimit dhe rishikimit të tyre, që e rrit efektivitetin e strategjisë dhe masave klimatike me kohën. Ndërtimi i njohurive nëpër institucione dhe përdorimi i tyre nga agjencitë dhe kështu me radhë, janë faktorë të rëndësishëm që kufizojnë punën e qeverisë në përballimin e tranzicionit për klimën. Qeveria duhet të zhvillojë Planin e saj për Zhvillimin e Kapaciteteve Institucionale për

NK, si pjesë e një politike të pavarur ku mund të përfshihet partneritet me programet e OKB-së dhe / ose agjencitë e tjera donatore. Nevojitet një mendim më strategjik i qeverisë në këtë drejtim.

Modelet: Nuk ka asnjë model 'prototip' të asaj që konsiderohet kapacitet institucional për klimën. Ndërtimi i kapaciteteve institucionale duhet të fokusohet në përmirësimin e performancës funksionale, që përfaqësohet përmes proceseve të integruara të planifikimit dhe vendimmarrjes.

Qasja në burime: Institucionet duhet të jenë në gjendje të zhvillojnë aftësi bindëse lidhur me nevojën për burime, për t'iu përgjigjur ndryshimeve klimatike, për shembull lidhur me informacionin dhe personelin, financat shtesë të nevojshme për klimën, rishpërndarjen e buxheteve bazë, etj. Kjo do kërkonte përshkrim të detajuar të kostove shtesë për veprimtaritë e përshtatëse ndaj klimës dhe shprehje në mënyrë të qartë të kontributit financiar të nevojshëm, përkundër objektivave prioritare. Pritet **përdorim më i mirë i portalit e-Albania**, i cili edhe pse funksional nuk arrin të ndihmojë përdoruesit në kërkesat e ndryshme të njohura nga ligji për të drejtën e informacionit. Informacioni i disponueshëm në rastin më të mirë ose nuk mund të filtrohet sipas formatit të kërkuar, ose nuk ekziston. Pengesat kryesore që janë shkak për mbështetjen e kufizuar ndaj masave të përshtatjes nga institucionet publike dhe paaftësia e tyre për të luajtur një rol më të mirë në zhvillimin e qëndresës ndaj ndryshimeve klimatike, lidhen me boshllëqet në menaxhim, mungesën e burimeve financiare dhe fizike, si dhe mungesën ose trajnimin e pamjaftueshëm.

Shtojca 1

Lista e projekteve të Ndhmës së Huaj për Shqipërinë, të lidhura me klimën (2019-2021)¹⁷

Projekti	Donatori	Shuma (USD)
Trajnimi, Edukimi dhe Pyllëzimi për zhvillimin e Qëndrueshëm të pyjeve në Shqipëri	Austri	400,000
Projekti i Shërbimeve Mjedisore	BB	22,840,000
BE për ekonominë qarkulluese dhe rritjen e gjelbër	BE	23,116,500
ALTOUR	BE	175,586
Fire-PREP	BE	71,461
Resource	BE	131,000
TUNE-UP	BE	110,635
Projekti për përmirësimin e menaxhimit të ligatinave në Balkan për mbrojtjen e pelikanit kacurel	France	425,794
Programi për menaxhimin e mbetjeve të ngurta	Gjermani	12,649,726
Transport publik miqësor me klimën, Tiranë	Gjermani	4,000,000
Menaxhim i integruar dhe riciklues i mbetjeve, miqësor me mjedisin	Gjermani	300,000
Ruajtja e Agro-biodiversitetit në zonat rurale	Gjermani	2,902,981
Rezerva nderkufitare biosferike, Prespë	Gjermani	3,500,000
Përgatitja e një databaze me informacion gjeografik lidhur me përshtatjen	Hungari	70,000
Veprim i komuniteteve për ruajtjen e zonave të mbrojtura në Shqipëri	Itali	2,021,870
Qëndrueshmëri mjedisore në Shqipëri	Itali	20,000
Përmirësimi i menaxhimit efektiv të zonave detare dhe të mbrojtura në Shqipëri	Itali	1,184,475
Program i Qendrueshëm dhe Ekoturizmi - Projekti kombëtar dhe rajonal i rrugëve	Itali	20,000
Gjelbërim për përmirësim mjedisor në Bashkinë e Korçës	Japoni	90,000
Kambion për grumbullimin e mbetjeve për Bashkinë e Kukësit	Japoni	90,000
Menaxhimi i kimikateve në Shqipëri	Suedi	951,786
Monitorim dhe shërbime këshillimi për perspektivën gjinore dhe mjedisin 2020-23	Suedi	84,873
Monitorim dhe shërbime këshillimi për mjedisin në Shqipëri	Suedi	296,685

¹⁷Zyra e Koordinimit të ndihmës së huaj, Drejtoria e Borxhit të Brendshëm, Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Monitorimi i perspektivës gjinore në burimet natyrore 2017-20	Suedi	78,385
Monitorimi i burimeve natyrore 2017-19 Alb	Suedi	270,326
Planifikim i ujit të pijshëm dhe ujrave të zeza për nrgociatat me BE-në	Suedi	2,115,081
Natyra 2000	Suedi	67,129
SEPA, mbështetje për negociatat me BE_në	Suedi	2,346,320
SANE27 Faza 2	Suedi	2,085,462
Mbështetje për Ministrinë e Mjedisit	Suedi	2,204,197
Ne Ndikojmë Kornizën	Suedi	6,168
Projekti i Shërbimeve Mjedisore	Suedi	13,185,323
Zonat e mbrojtura detare dhe bregdetare 2	UNDP	1,093,266
Maritime OSR Detar dhe vlerësimi i riskut	UNDP	244,047
Infrastrukturë për mbrojtjen nga përmbytjet	UNDP	6,966,748
Zhvillimi i sektorit detar në Shqipëri	UNDP	1,007,510
Përshtatje me ndryshimet klimatike i rrezikut ndërkufitar nga përmbytjet në Bakllanin Perëndimor	Gjermani	3,450,000
Ruajtja dhe përdorimi i qëndrueshëm i biodiversitetit në liqenin e Ohrit, Prespës dhe Shkodrës (Faza III)	Gjermani	800,000

Shtojca 2:

Intervista gjysmë të strukturuar me Institucionet e Qeverisjes Qendrore

1. Kuadri Ligjor: Zhvillimet dhe nevojat

- 1.1 Në këndvështrimin e institucionit tuaj, cila është situata lidhur me zbatimin e Strategjisë? A ka ndonjë shqetësim për sa i përket hartimit dhe zbatimit të legjislacionit për klimën? Cilat janë boshllëqet e rëndësishme në kuadrin ligjor lidhur me klimën?
- 1.2 Si e vlerësoni progresin e bërë në Shqipëri në përafrimin e legjislacionit për klimën me kuadrin e legjislacionit të BE-së për klimën?
- 1.3 A ndikojnë proceset e angazhimit global për klimën në progresin e vendit për zhvillimet ligjore të klimës? Çfarë po ndodh në lidhje me COP26?
- 1.4 A promovon vizioni apo programi politik i qeverisë angazhim dhe gatishmëri për klimën?
- 1.5 Sa përfarohet strategjia me financat për veprimin klimatik? Cilat të dhëna janë të gjurmueshme për të monitoruar rezultatet dhe efikasitetin e fondeve në veprimet klimatike? A ka ndonjë sistem për gjurmimin e dimensionit klimatik në projektet e financuara?

2. Ndryshimet klimatike dhe Agjenda e Gjelbër për Ballkanin Perëndimor parashikuar nga Marrëveshja e Gjelbër Evropiane

Në të gjithë botën, politikat e përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike të mbështetura nga Konventa Kuadër e Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike (UNFCCC) kanë ofruar burime të rëndësishme financimi dhe mbështetje teknike për vendet në zhvillim. Megjithatë, shpesh përgjigjet e propozuara të përshtatjes kundërshtojnë realitete komplekse politike, veçanërisht në kontekste politikisht të paqëndrueshme, ku pushteti dhe politika formëzojnë rezultatet e përshtatjes.

- 2.1 Si e shihni rolin e institucionit tuaj në reduktimin e efekteve të ndryshimeve klimatike? Cilin sektor parashikoni si më të rëndësishëm për të ndërhyrë?
- 2.2 A njihet Ndryshimet Klimatike nga strukturat e institucioneve? A është mbështetur ndonjë program për klimën nga institucioni juaj dhe në çfarë mase ndërvepron institucioni me ndryshimet klimatike?
- 2.3 A ka stimuj/barriera që nxisin/pengojnë institucionin tuaj në zhvillimin e trajnimeve dhe ngritjen e kapaciteteve që nevojiten për zhvillimin dhe miratimin e politikave klimatike? A janë bërë përpjekje për të nxitur legjislacionin për politikat klimatike dhe sa është angazhuar Institucioni juaj në adresimin e barrierave dhe kufizimeve në përmbushjen e detyrimeve?
- 2.4 A ka projeksione të zhvilluara dhe të zbërthyera qartë nga Qeveria, për sa i përket reduktimit të shkarkimeve dhe gatishmërisë së vendit për objektiva në rritje përmes ristrukturimit të ekonomisë (në sektorë si transporti dhe lëvizshmëria, përdorimi i tokës, ekonomia qarkulluese, etj.)?
- 2.5 Cilat janë burimet, kapacitetet dhe nevojat e pashfrytëzuara të institucionit për të ushqyer inovacionin e gjelbër dhe parimet e ndryshimeve klimatike për arritjen e objektivave të Strategjisë Kombëtare për Ndryshimet Klimatike?

Bibliografia

Climate Action Network Europe (2020): Një BE pa karbon: Gjetje të skenarit për energjinë në Marrveshjen e Parisit

<https://caneurope.org/net-zero-eu-is-possible-findings-from-ngos-paris-agreement-compatible-energy-scenario/>

Climate Action Network Europe (2021): Studim: Objektivat e Marrveshjes së Parisit për Klimën janë të arritshme por kërkojnë zvogëlim të shkajshëm të shkarkimeve,

<https://caneurope.org/study-paris-agreement-climate-goal-steep-emission-reductions/>

Climate Action Network Europe (2021): Komisioni duhet ti japë jetë premtimeve në Marrveshjen e Gjelbërt dhe të ndërpresë subvencionet për lëndët fosile

<https://caneurope.org/can-europe-urges-ec-to-revise-ceeag/>

Climate Action Network Europe (2021): Deklaratë për Shtyp: Paketa "Fit for 55" con përpara objektivat e BE dhe nuk përmbush ambiciet

<https://caneurope.org/press-release-fit-for-55-climate-energy-eu-commission-package/>

Climate Action Network Europe (2021): Deklaratë për media: Paketa legjislative e BEsë për klimën dhe energjisë duhet të jetë 'Fit for 1.5°C

<https://caneurope.org/climate-energy-legislative-package-ff55/>

Climate Action Network Europe (2021): Targeti për burimet e rinovueshme duhet të jetë në linjë objektivat e BE për klimën

<https://caneurope.org/renewables-target-must-be-aligned-with-the-eu-higher-climate-ambition/>

Komisioni Evropian (2021): Raporti për Shqipërinë 2020

https://www.google.com/url?sa=t&rct=j&q=&esrc=s&source=web&cd=&ved=2ahUKEwjwKn7q9zzAhWLCOWKHa0ZCmqQFnoECAYQAQ&url=https%3A%2F%2Fec.europa.eu%2Fneighbourhood-enlargement%2Fsystem%2Ffiles%2F2020-10%2Falbania_report_2020.pdf&usq=AOvVaw29NByoceEd8O9244xPX9dC

Komisioni Evropian (2021): Raporti për Shqipërinë 2021

https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/albania-report-2021_en

Agjencia Ndërkombëtare e Energjitë e Rinovueshme (IRENA), 2021: Albania – Burimet e Rinovueshme, Gadishmëria dhe Vlerësimi

<https://www.irena.org/publications/2021/March/Renewables-Readiness-Assessment-Albania>

Climate Action Network Europe (2021): Vlerësim i vitit 2021 i Direktivës për Eficencën e Energjisë: ta bëjmë të vlefshme

<https://caneurope.org/energy-efficiency-directive-review/>

Kuvendi i Shqipërisë (2019): Strategjia Kombëtare për Ndryshimet Klimatike dhe Plani i Veprimit, 2020-2030 <https://qbz.gov.al/eli/fz/2019>

Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2021): Programi Buxhetor Afatmesëm 2021-2023 <https://www.financa.gov.al/programi-buxhetor-afatmesem-2021-2023-faza-ii/>

OECD (2021): Përfitimet ekonomike dhe mjedisore prej kordinimit ndërkombëtar për cmimin e karbonit

<https://doi.org/10.1787/d4d3e59e-en>

OECD (2020): Grupi i Ekspertëve për Ndryshimet klimatike: Raportimi kombëtar i inventarit të gazeve serë përmes Tabelave të Raportimit të Përbashkët (CRTs)

<https://doi.org/10.1787/c4f45e18-en>

OECD (2018): Financimi i të Ardhmes së Klimës: ridizajn i infrastrukturës

<https://www.oecd.org/environment/cc/climate-futures/>

PNUD Shqipëri (2016): Komunikimi i Tretë Kombëtar i Shqipërisë për KKKBNK

https://www.al.undp.org/content/albania/en/home/operations/projects/environment_and_energy/third-national-communication-of-albania-to-the-united-nations-fr.html

Grupi i Bankës Botërore (2021): Shqipëria – Profili i vendit për rrezikun e klimës

<https://climateknowledgeportal.worldbank.org/sites/default/files/2021-06/15812-Albania%20Country%20Profile-WEB.pdf>

Faqe interneti:

Agencia e Eficencës së Energjisë www.eficenca.gov.al

Agencia Kombëtare e Mjedisit www.akbm.gov.al

Agency Kombëtare e Burimeve Natyrore www.akbn.gov.al

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit <http://turizmi.gov.al/>

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë www.infrastruktura.gov.al

Qendra e Botimeve Zyrtare www.qbz.gov.al

Fondacioni Westminster për Demokraci (WFD) është organ publik i Mbretërisë së Bashkuar i dedikuar për të mbështetur demokracinë në mbarë botën. Duke vepruar ndërkombëtarisht, WFD punon me parlamentet, partitë politike dhe grupet e shoqërisë civile, si dhe me zgjedhjet për të ndihmuar shtetet të kenë sisteme politike më të drejta, më gjithëpërfshirëse dhe të përgjegjshme.



www.wfd.org



@WFD_Democracy



@WestminsterFoundation



Fondacioni Westminster për Demokraci është një organ ekzekutiv publik i sponsorizuar nga Ministria e Punëve të Jashtme, Komonuelthit dhe Zhvillimit.

